

201909601207

## LIGJ PËR KUNDËRVAJTJE

### DISPOZITA THEMELORE

#### Lënda e ligjit

##### Neni 1

Me këtë ligj rregullohen kushtet e përgjithshme për përcaktim të kundërvajtjeve dhe sanksioneve për kundërvajtje, kushtet e përgjithshme për përcaktim të përgjegjësisë për kundërvajtje, për shqiptimin dhe ekzekutimin e sanksioneve për kundërvajtje dhe përcaktohen procedurat për kundërvajtje.

#### Zbatimi i dispozitave të ligjeve tjera

##### Neni 2

(1) Për kundërvajtjen dhe përgjegjësinë për kundërvajtje në mënyrë përkatëse aplikohen dispozitat nga pjesa e përgjithshme e Kodit Penal.

(2) Nëse me dispozitat e këtij ligjit nuk është përcaktuar ndryshe, gjykatat në procedurën për kundërvajtje i aplikojnë dispozitat nga Ligji për procedurën për kundërvajtje që kanë të bëjnë me parimet themelore: gjuha, kompetenca vendore, pasoja prej jokompetencës, konflikt interesash, përjashtim, i akuzuar, mbrojtës, parashtresa, procesverbale, afate, kërkesë pronëso-ro-juridike, miratim dhe kumtim të vendimeve, dorëzim të dokumenteve dhe mjete të rregullta dhe të çrregullta juridike.

(3) Organi për kundërvajtje gjatë mbajtjes së procedurës për kundërvajtje në mënyrë përkatëse i aplikon dispozitat nga Ligji për procedurë të përgjithshme administrative, përveç nëse me ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

(4) Klasifikimi i shoqërive tregtare në të vogla, të mesme dhe të mëdha përcaktohet në pajtim me dispozitat e Ligjit për shoqëritë tregtare.

(5) Dispozitat nga ligji që e rregullon përdorimin e gjuhëve në Republikën e Maqedonisë dhe në njësitë e vetëqeverisjes lokale në mënyrë përkatëse aplikohen në procedurën për kundërvajtje.

#### Kuptimi i shprehjeve në këtë ligj

##### Neni 3

(1) Me nocionin person fizik në aspekt të këtij ligji nënkuptohet çdo person në moshë madhore kryerës i kundërvajtjes, person përgjegjës në person juridik, tregtar individual, person zyrtar i autorizuar dhe person i cili kryen veprimtari në mënyrë të pavarur.

(2) Me person juridik nënkuptohen: Republika e Maqedonisë, organet publike, njësitë e vetëqeverisjes lokale, ndërmarrjet publike, shoqëritë tregtare, entet, partitë politike, shoqatat, fondacionet, lidhjet dhe format organizative të organizatave të huaja, shoqata sportive dhe persona tjerë juridikë nga fusha e sportit dhe persona tjerë juridikë dhe bashkësi tjera si dhe organizatat të cilave u është njohur cilësia e personit juridik.

(3) Me person i huaj juridik nënkuptohet ndërmarrje publike, ent, fond, bankë, shoqëri tregtare apo formë tjerë e organizimit sipas ligjeve të shtetit të huaj në kryerjen e veprimtarive ekonomike, financiare, bankare, tregtare, hotelierike dhe tjera, që ka seli në shtet tjetër apo përfaqësi në Republikën e Maqedonisë ose është themeluar si shoqëri ndërkombëtare, fond, bankë apo institucion.

(4) Organ publik paraqesin ministritë dhe organet tjera të administratës shtetërore, organizata të caktuara me ligj, personat juridikë dhe fizikë të cilëve me ligj u është besuar të kryejnë autorizime publike, si dhe organet e komunës, të Qytetit të Shkupit dhe komunave në Qytetin e Shkupit.

(5) Organe shtetërore janë ministritë, organet tjera të administratës shtetërore, organet e pushtetit ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor.

(6) Si person përgjegjës në person juridik konsiderohet personi i cili duke pasur parasysh funksionin e vet apo në bazë të autorizimit të veçantë në personin juridik i është besuar fushëveprim i caktuar i punëve që kanë të bëjnë me zbatimin e dispozitave ligjore ose të dispozitave të miratuara në bazë të ligjit, akt të personit juridik në menaxhimin, shfrytëzimin dhe menaxhimin me pronë, udhëheqjen me intervenimin prodhues ose afarist, ndonjë proces tjetër ekonomik apo mbikëqyrjen mbi ato. Kur kjo është veçanërisht e paraparë me këtë ligj, si person përgjegjës konsiderohet edhe personi i cili kryen funksion të veçantë apo autorizim apo të cilit i është besuar kryerje e pavarur e punëve të caktuara në person të huaj juridik, si dhe personi i cili është përfaqësues i personit të huaj juridik në Republikën e Maqedonisë.

(7) Si person zyrtar konsiderohet:

a) funksionar i zgjedhur apo emëruar në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë, në organet e administratës shtetërore, në gjykatat dhe organe tjera dhe organizata që kryejnë punë të caktuara profesionale, administrative dhe tjera në suazat e të drejtave dhe obligimeve të Republikës, në njësitë e vetëqeverisjes lokale, si dhe persona të cilët vazhdimisht apo përkohësisht kryejnë detyrë zyrtare në këto organe dhe organizata;

b) person i autorizuar në person juridik të cilit me ligj apo me dispozitë tjetër të miratuar në bazë të ligjit i është besuar kryerje e autorizimeve publike, kur obligimin e kryen në kuadër të atyre autorizimeve;

c) person i autorizuar nga funksionari i cili mban dhe kompletton procedurën dhe kryen obligime të caktuara zyrtare në bazë të autorizimit të paraqitur me ligj apo me dispozita tjera dhe akte të miratuara në bazë të ligjit;

ç) personel ushtarak kur bëhet fjalë për kundërvajtje tek të cilat si kryerës është shënuar person zyrtar;

d) nëpunës administrativ i cili ka themeluar marrëdhënie pune për shkak të kryerjes së punëve administrative në ndonjë prej këtyre institucioneve: organet e pushtetit shtetëror dhe lokal dhe organeve tjera shtetërore të themeluara në pajtim me Kushtetutën dhe me ligj dhe institucionet të cilat kryejnë veprimtari nga fusha e arsimit, shkencës, shëndetësisë, kulturës, punës, mbrojtjes sociale dhe mbrojtjes së fëmijëve, sportit si dhe në veprimtari tjera me interes publik të caktuar me ligj, kurse të organizuara si agjenci, fonde, ente publike dhe ndërmarrje publike të themeluara nga Republika e Maqedonisë apo prej komunave, nga Qyteti i Shkupit, si dhe prej komunave në Qytetin e Shkupit;

dh) përfaqësues i shtetit të huaj apo i organizatës ndërkombëtare në Republikën e Maqedonisë.

(8) Me nocionin personel ushtarak konsiderohen. eprorë ushtarak – oficerë dhe nënoficerë, ushtarë në shërbim të ushtrisë, kadetë të Akademisë Ushtarake, person për aftësim dhe përsosje profesionale për oficer dhe nënoficer, të angazhuar ushtarak në përbërjen rezerve të Armatës së Republikës së Maqedonisë derisa janë thirrur të kryejnë të drejta dhe obligime nga fusha e mbrojtjes në lidhje me kryerjen e obligimit ushtarak dhe personeli civil në shërbim në Armatën e Republikës së Maqedonisë.

(9) Procedurë për kundërvajtje është procedura të cilën në pajtim me dispozitat e këtij ligji e mban gjykata, organi për kundërvajtje dhe person i autorizuar zyrtar.

(10) Me organe për kundërvajtje në aspekt të këtij ligji nënkuptohen: organet publike, trupat e pavarur rregullator dhe organet tjera kompetente në pajtim me Ligjin për mbajtje të procedurës për kundërvajtje dhe shqiptim të sanksioneve për kundërvajtje.

(11) Person i autorizuar zyrtar është personi zyrtar në organ publik i cili është i autorizuar të japë urdhërpagesë për kundërvajtje, mban procedurë për kundërvajtje dhe shqipton sanksione për kundërvajtje në procedurat për kundërvajtje të caktuara me ligj.

(12) Kryerës i pavarur i veprimtarisë konsiderohet personi i cili kryen veprimtari në bazë të lejeve apo pëlqimeve të përcaktuara.

(13) Me nocionin gjobë, konsiderohet shumë me para e llogaritur në kundërvlerë me denarë të shumës së kursit mesatar të euros sipas Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë në kohën e shqiptimit të gjobës së përlllogaritur në kundërvlerë me denarë pa decimale.

Pjesa e parë

## DISPOZITAT MATERIALE-JURIDIKE

Kreu i parë

### DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

#### **Parim i ligjshmërisë në përcaktimin e kundërvajtjeve dhe në përcaktimin e sanksioneve për kundërvajtje**

Neni 4

Askujt nuk mund t'i shqiptohet sanksion për kundërvajtje i cili para se të jetë kryer nuk ka qenë i përcaktuar si kundërvajtje me ligj dhe për të cilin me ligj nuk është përcaktuar sanksion për kundërvajtje.

#### **Ndalimi për shqiptim të dyfishtë të sanksioneve**

Neni 5

Askush nuk mund sërish të sanksionohet për kundërvajtje për të cilën është mbajtur procedurë dhe për veprimin e njëjtë i është shqiptuar sanksion penal apo për kundërvajtje.

#### **Parimi i proporcionalitetit**

Neni 6

(1) Gjatë mbajtjes së procedurës për kundërvajtje gjykata përkatësisht organi për kundërvajtje duhet t'i mundësojë palës t'i realizojë dhe mbrojë të drejtat dhe interesat juridike të saj, nëse të njëjta nuk janë në dëm të të drejtave dhe interesave juridike të palëve tjera apo personave të tretë dhe nuk janë në dëm të interesit publik të caktuar me ligj.

(2) Kur palët në procedurën për kundërvajtje u imponojnë obligime, gjykata përkatësisht organi për kundërvajtje është i obliguar t'i aplikojë ato veprime të cilat janë më të volitshme për palët, nëse veprimet e tilla janë të mjaftueshme për t'u arritur qëllimi i caktuar me ligj.

#### **Sanksione për kundërvajtje**

Neni 7

Për kundërvajtje të kryer me kushtet e këtij ligji, shqiptohen:

- 1) sanksione për kundërvajtje për persona fizikë,
- 2) sanksione për kundërvajtje për persona juridikë dhe
- 3) masa të veçanta për kundërvajtje.

## Kreu i dytë

### KUNDËRVAJTJE DHE PËRGJEGJËSI PËR KUNDËRVAJTJE

#### **Kundërvajtja**

##### Neni 8

Kundërvajtje është veprë e kundërligjshme e cila me ligj është përcaktuar si kundërvajtje, karakteristikat e të cilës janë përcaktuar me ligj dhe për të cilën është përcaktuar sanksion për kundërvajtje.

#### **Përgjegjësia e personit fizik**

##### Neni 9

(1) Për përgjegjësi të personit fizik mjafton pakujdesia, nëse me ligjin në të cilin është caktuar kundërvajtja nuk është përcaktuar se kryerësit do t'i shqiptohet sanksion për kundërvajtje vetëm kur kundërvajtja është kryer me paramendim.

(2) Personit përgjegjës në personin juridik do t'i shqiptohet sanksion për kundërvajtje kur deri në kryerje të kundërvajtjes ka ardhur me veprim të tij, lëshim të veprimit dhe lëshim të tij në mbikëqyrje obligative.

(3) Nëse personi i njëjtë është kryerës i kundërvajtjes së njëjtë si person fizik si dhe person përgjegjës në person juridik do të jetë përgjegjës vetëm si person fizik.

#### **Përgjegjësia e personit juridik**

##### Neni 10

(1) Personi juridik mund të përgjigjet për kundërvajtje vetëm nëse kjo është përcaktuar me ligjin me të cilin është përcaktuar kundërvajtja.

(2) Personi juridik është përgjegjës për kundërvajtje nëse deri në kryerje të kundërvajtjes ka ardhur me veprim, lëshim të veprimit apo me lëshim në mbikëqyrjes obligative nga ana e organit kompetent apo të personit përgjegjës në personin juridik apo me veprim ose lëshim të personit tjetër që ka qenë i autorizuar të veprojë në emër të personit juridik, në suazat e mbikëqyrjes së tij, apo kur ai i ka tejkaluar autorizimet e tij për shkak të realizimit të fitimit për personin juridik.

(3) Përgjegjësia për kundërvajtje të personit juridik nuk e përjashton përgjegjësinë e kryerësit të kundërvajtjes.

(4) Për veprat e caktuara me ligj, përgjegjësi për kundërvajtje kanë të gjithë personat juridikë, me përjashtim të Republikës së Maqedonisë, organeve shtetërore dhe këshillat e njësive të vetëqeverisjes lokale.

(5) Personi juridik që është në falimentim është përgjegjës për kundërvajtje të kryer para fillimit të procedurës për falimentim dhe mund t'i shqiptohet vetëm masë e veçantë për konfiskim të pronës, dobisë pronësore dhe konfiskim i sendeve.

## **Përgjegjësia e personit të huaj juridik**

### Neni 11

Personi i huaj juridik ka përgjegjësi për kundërvajtje nëse kundërvajtja është kryer në territorin e Republikës së Maqedonisë apo kundërvajtja ka shkaktuar pasoja në territorin e Republikës së Maqedonisë.

## **Përgjegjësia për kundërvajtje të tjetrit**

### Neni 12

(1) Personi përgjegjës në person juridik, në rastet e parapara me ligj, përgjigjet për kundërvajtje të kryer prej të punësuarit në atë person juridik, nëse deri te kundërvajtja ka ardhur me lëshim të mbikëqyrjes së detyrueshme mbi punën.

(2) Përgjegjësia e personit përgjegjës në personin juridik nuk e përjashton përgjegjësinë e kryerësit të kundërvajtjes.

## **Përgjegjësia e personit zyrtar në organ publik**

### Neni 13

Personi zyrtar në organ publik është përgjegjës nëse kundërvajtjen e ka kryer në suazat e autorizimeve zyrtare të tij ose nëse gjatë kryerjes së autorizimeve zyrtare i ka shkelur autorizimet zyrtare.

## **Tentimi**

### Neni 14

Nuk ka përgjegjësi për tentim për kundërvajtje, përveç në rastet e caktuara me ligj.

## **Ndihmues dhe stimulus**

### Neni 15

Nuk ka përgjegjësi për stimulim apo ndimë për kundërvajtje, përveç në rastet e caktuara me ligj.

## **Rregulla të përgjithshme për përcaktim të sanksionit për kundërvajtje**

### Neni 16

(1) Kryerësit të kundërvajtjes i përcaktohet sanksion për kundërvajtje në kufijtë që me ligj janë përcaktuar për kundërvajtje të kryer, duke i pasur parasysh përgjegjësinë për kundërvajtje të kryerësit dhe peshën e kundërvajtjes.

(2) Gjatë përcaktimit të sanksionit për kundërvajtje merren parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë që sanksioni për kundërvajtje të jetë më i lehtë apo më i rëndë (rrethana lehtësuese dhe vështirësuese), kurse veçanërisht: shkalla e përgjegjësisë së kryerësit për kundërvajtje, motivet për të cilat është kryer kundërvajtja, shkalla e rrezikimit ose cenimit të së mirës së mbrojtur, rrethanat me të cilat është kryer kundërvajtja, jeta e mëparshme e kryerësit, situatat e tij personale dhe sjellja e tij pas kundërvajtjes veçanërisht nëse e ka kompensuar dëmin, si dhe rrethanat tjera që kanë të bëjnë me personalitetin e kryerësit.

(3) Gjatë përcaktimit të gjobës merret parasysh gjendja pronësore e kryerësit, lartësia e pagës së tij, të ardhurat tjera të tij, prona e tij dhe obligimet e tij familjare, tek kundërvajtjet nga fusha e tatimeve dhe doganat dhe proporcionaliteti i lartësisë së detyrimeve të papaguara për të cilat është i obliguar me ligj.

(4) Sanksionet për kundërvajtje të shqiptuara për kundërvajtje paraprakisht të kryer nuk mund të llogariten si rrethanë vështirësuese, nëse nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit për kundërvajtje deri në kryerje të kundërvajtjes së re ka kaluar më shumë se një vit.

### **Varg**

#### **Neni 17**

(1) Nëse kryerësi me një veprim apo më shumë veprime ka kryer më shumë kundërvajtje, por nuk është miratuar vendim për kundërvajtje, paraprakisht do të përcaktohet sanksion për kundërvajtje për çdo kundërvajtje veçmas, e pastaj do të shqiptohen si sanksion i vetëm për kundërvajtje për të gjitha sanksionet e caktuara për kundërvajtje në atë mënyrë.

(2) Nëse për më tepër kundërvajtje të kryera në varg është përcaktuar gjobë do të shqiptohet sanksion i vetëm për kundërvajtje që është e barabartë me totalin e gjobës së caktuar veçmas, që nuk mund të tejkalojë maksimumin ligjor të gjobës të caktuar me ligj.

### **Kundërvajtja e vazhduar**

#### **Neni 18**

(1) Kryerësit i cili duke e shfrytëzuar raportin e njëjtë të përhershëm, rastet e njëjta apo rrethanat tjera të ngjashme, do të kryejë dy apo më shumë veprime të lidhura në kohë që paraqesin kryerje e shumëfishtë e kundërvajtjes së njëjtë, do t'i shqiptohet sanksion i vetëm për kundërvajtje në kufijtë e sanksionit për kundërvajtje të caktuar për atë kundërvajtje.

(2) Kryerësit i cili me kushtet nga paragrafi (1) i këtij neni do të kryejë dy ose më shumë veprime të lidhura kohore që paraqesin kryerje të kundërvajtjeve të njëjta, do t'i shqiptohet sanksion në kufijtë e sanksionit për kundërvajtje të caktuar për kundërvajtjen më të rëndë.

### **Lirim prej sanksionit për kundërvajtje**

#### **Neni 19**

(1) Gjykata, përkatësisht organi për kundërvajtje mund ta lirojë prej sanksionit për kundërvajtje kryerësin e kundërvajtjes vetëm kur është përcaktuar në mënyrë të prerë me ligj.

(2) Gjykata, përkatësisht organi për kundërvajtje mund ta lirojë prej sanksionit për kundërvajtje, kryerësin e kundërvajtjes, t'ia zvogëlojë gjobën pa kufizime të caktuara për zvogëlim të gjobës apo ta lirojë vetëm nga sanksioni për kundërvajtje ndalesë për drejtim të mjetit motorik apo dëbim të shtetasit të huaj nga shteti.

### **Bazë e posaçme për lirim prej sanksionit për kundërvajtje**

#### **Neni 20**

Gjykata, përkatësisht organi për kundërvajtje mund ta lirojë prej sanksionit për kundërvajtje kryerësin e kundërvajtjes të kryer nga pakujdesia kur pasojat e kryerësit të kundërvajtjes kanë ndikim aq të madh sa që shqiptimi i sanksioni për kundërvajtje në rast të tillë nuk përputhet me qëllimin e sanksionimit.

## **Zvogëlimi i gjobës dhe lirimi për shkak të mënjanimit të pasojave të dëmshme të kundërvajtjes**

### **Neni 21**

(1) Kur kundërvajtja është kryer në rrethana veçanërisht lehtësuese, gjoba mund të zvogëlohet deri në minimumin e përgjithshëm ligjor të caktuar në nenet 26 dhe 36 të këtij ligji.

(2) Për kundërvajtjen e kryer në kushte veçanërisht lehtësuese, për çka është përcaktuar sanksion për kundërvajtje, gjykata përkatësisht organi për kundërvajtje mund ta lirojë kryerësin prej sanksionit për kundërvajtje nëse kryerësi vetë e paraqet kundërvajtjen para se i njëjti të zbulohet ose nëse deri në kryerjen e procedurës së kundërvajtjes ia kthen fitimin që ka marrë nga i dëmtuari, e kompenson dëmin apo në mënyrë tjetër dëmshpërblen ose i korrigjon pasojat e dëmshme të kundërvajtjes.

### **Kreu i tretë**

## **SANKSIONE PËR KUNDËRVAJTJE PËR PERSONA FIZIKË**

### **Lloje të sanksioneve për kundërvajtje për persona fizikë**

### **Neni 22**

Për kundërvajtje të kryerësve me përgjegjësi për kundërvajtje mund t'u shqiptohen këto sanksione për kundërvajtje:

- 1) vërejtje;
- 2) punë me interes të përgjithshëm;
- 3) gjobë;
- 4) pikë negative;
- 5) ndërprerje e vlefshmërisë së patentës për shofer;
- 6) ndalesë për drejtim të mjetit motorik;
- 7) ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë apo detyrës,
- 8) dëbim të shtetasit të huaj nga shteti;
- 9) ndalesë për hyrje apo prezencë në ndeshje sportive dhe
- 10) ndalesë për shfrytëzim të subvencioneve dhe mjeteve tjera të siguruar nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

### **Kushte për shqiptim të sanksioneve për kundërvajtje**

### **Neni 23**

(1) Vërejtja shqiptohet si sanksion i pavarur për kundërvajtje apo në zëvendësim për gjobën kur bëhet fjalë për kundërvajtje të kryer në rrethana të tilla lehtësuese që e bëjnë veçanërisht të lehtë apo kur me shqiptimin e saj arrihet qëllimi i ligjit.

(2) Punë me interes të përgjithshëm shqiptohet si sanksion i veçantë për kundërvajtje apo si zëvendësim të gjobës kur gjoba nuk mund të zbatohet në pajtim me raste të caktuara me ligj.

(3) Gjoba shqiptohet si sanksion kryesor për kundërvajtje.

(4) Pikët negative shqiptohen si zëvendësim i gjobës.

(5) Ndërprerje e vlefshmërisë së patentës për shofer apo ndalesë për drejtim të mjetit motorik shqiptohen me gjobë, vërejtje apo si sanksione të pavarura për kundërvajtje në rastet e caktuara me ligj.

(6) Ndalesa e kryerjes së profesionit, veprimtarisë apo detyrës shqiptohet si sanksion i veçantë për kundërvajtje, kurse në rast të kryerjes së sërishme të kundërvajtjes shqiptohet bashkë me gjobë.

(7) Dëbim i shtetasit të huaj nga vendi shqiptohet bashkë me gjobë, vërejtje apo si sanksion i veçantë për kundërvajtje në rastet e caktuara me ligj.

(8) Ndalesa për hyrje dhe prani në ndeshje sportive shqiptohet bashkë me gjobën apo si sanksion i pavarur për kundërvajtje në rastet e caktuara me ligj.

(9) Ndalesë për shfrytëzim të subvencioneve dhe mjeteve tjera të siguruar prej Buxhetit të Republikës së Maqedonisë shqiptohet bashkë me gjobën, vërejtjen apo si sanksion i veçantë për kundërvajtje në rastet e caktuara me ligj.

### **Vërejtje**

#### **Neni 24**

(1) Vërejtja shqiptohet për kundërvajtje të kryer në rrethana të tilla lehtësuese që e bëjnë veçanërisht të lehtë apo kur me shqiptimin e saj arrihet qëllimi i ligjit.

(2) Vërejtja mund të shqiptohet edhe nëse kundërvajtja përbëhet nga mosplotësimi i obligimit të caktuar apo me kundërvajtjen është shkaktuar dëm, kurse kryerësi para vendimit për kundërvajtje e ka plotësuar obligimin e caktuar, përkatësisht e ka mënjeluar apo ka kompensuar dëmin e shkaktuar apo nëse kundërvajtja është kryer për herë të parë dhe nuk ka shkaktuar pasoja të dëmshme për person të tretë, as nuk ka qenë i rrezikuar interesi publik.

### **Punë me interes të përgjithshëm**

#### **Neni 25**

(1) Për kundërvajtje të personit fizik për të cilën është paraparë gjobë, gjykata mund të shqiptojë punë me interes të përgjithshëm në kohëzgjatje prej më së shumti 30 ditë.

(2) Masa e punës me dobi të përgjithshme shqiptohet në orë, jo më pak se pesë orë në javë, në periudhë prej më së shumti 30 ditësh.

(3) Gjatë shqiptimit të sanksionit për kundërvajtje, gjykata e përcakton lartësinë e gjobës dhe konstaton se ajo nuk do të zbatohet nëse personi i gjykuar për kundërvajtje pranon të punojë punë me interes të përgjithshëm. Me këtë rast çdo ditë punë me interes të përgjithshëm barazohet me gjobë në lartësi prej 15 euro në kundërvlerë me denarë.

(4) Punën me interes të përgjithshëm kryerësi është i obliguar ta kryejë në afat të caktuar prej gjykatës, pa kompensim, në organ publik apo organizatë humanitare, në ditë jo pune dhe festa. Kur ekzistojnë shkaqe shëndetësore apo të arsyeshme personale apo familjare, puna me interes të përgjithshëm mund të prolongohet më së shumti edhe për 30 ditë shtesë.

(5) Nëse kryerësi nuk e kryen punën me interes të përgjithshëm në afat të caktuar nga gjykata dhe nuk parashtron vërtetim që e ka kryer punën e dobishme, gjykata do t'i shqiptojë gjobë.

(6) Mënyra e realizimit të punës së dobishme do të zbatohet në pajtim me ligjin.

### **Gjoba**

#### **Neni 26**

(1) Gjoba për personin fizik përbëhet në pagesë të shumës së caktuar me para që nuk mund të jetë më e vogël se 15 euro në kundërvlerë me denarë as më e madhe se 250 euro në kundërvlerë me denarë, përveç nëse me legjislacionin e Bashkimit Evropian nuk është caktuar ndryshe.

(2) Gjoba për personin përgjegjës në personin juridik dhe personin e autorizuar zyrtar nuk mund të jetë më e vogël se 15 euro në kundërvlerë me denarë as më e madhe se 500 euro në kundërvlerë me denarë, përveç nëse me legjislacionin e Bashkimit Evropian nuk është caktuar ndryshe.



(3) Për kundërvajtje nga sfera e tatimeve, doganave, prokurimeve publike, financave publike dhe borxhit publik mund të përcaktohet gjobë në shumë më të madhe parash varësisht prej detyrimit të fshehur apo shumës së blerjes, por më së shumti në shumë të dyfishtë nga shuma e paragrafëve (1) dhe (2) të këtij neni.

(4) Për kundërvajtje në fushën e mbrojtjes së shëndetit të njeriut, mbrojtjes së pasurive natyrore, mjedisit jetësor, mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, mbrojtjes prej fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera, mund të përcaktohet gjobë në shumë të trefishtë nga shuma në paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni.

(5) Për kundërvajtje nga fusha e konkurrencës, energjetikës, komunikimeve elektronike, tregtisë me mallrave të ndaluara dhe/ose të kufizuara për përdorim, kundërvajtje të kryera prej lakmisë apo për kundërvajtje me të cilat shkaktohet dëm më i madh pronësor, mund të caktohet gjobë deri në shumën e dyfishtë nga maksimumi apo në proporcion me lartësinë e dëmit të shkaktuar apo dobinë e siguruar, por më së shumti deri në shumë të dhjetëfishtë nga shuma në paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni.

(6) Në vendimin për kundërvajtje përcaktohet afati për pagesë të gjobës që nuk mund të jetë më i shkurtër se tetë ditë as më i gjatë se 30 ditë nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit, me ç'rast zbatohet arkëtim i detyrueshëm, në pajtim me dispozitat nga Ligji për procedurë tatimore.

(7) Në raste të arsyeshme kur kryerësi nuk ka pronë të mjaftueshme, nuk është i punësuar, lëngon prej ndonjë sëmundjeje dhe rrethana tjera të ngjashme që e arsyetojnë atë, mund të lejohet gjoba të paguhet me këste. Në atë rast do të përcaktohet mënyra dhe afati i pagesës që nuk mund të jetë më i gjatë se gjashtë muaj.

### **Pikë negative**

#### **Neni 27**

Për kundërvajtje nga fusha e komunikacionit dhe kundërvajtje tjera të caktuara me ligj mund të përcaktohen pikë negative që i shqipton organi për kundërvajtje.

### **Ndërprerja e vlefshmërisë së patentë shoferit**

#### **Neni 28**

(1) Gjykata do të shqiptojë sanksion për kundërvajtje ndërprerje e vlefshmërisë së patentë shoferit, nëse është kryer kundërvajtje në fushën e komunikacionit rrugor me të cilin është shkakuar rrezik për krijim të pasojës së rëndë apo nëse është parashtruar dëshmi se kryerësi ka arritur 100 pikë negative në komunikacionin rrugor në tri vitet e fundit.

(2) Nëse shoferi për periudhë prej tri viteve të fundit arrin apo tejkalon 100 pikë negative në komunikacionin rrugor, gjykata do të shqiptojë sanksion për kundërvajtje ndërprerje e vlefshmërisë së patentë shoferit në kategorinë e mjetit motorik me të cilin ka arritur 100 pikë negative.

(3) Sanksioni i shqiptuar për kundërvajtje, ndërprerje e vlefshmërisë së patentë shoferit, nuk do të bëhet, nëse kanë kaluar tre vite nga plotfuqishmëria e vendimit për kundërvajtje.

(4) Në rastet nga paragrafi (1) i këtij neni, patenta e shoferit pushon të vlejë me plotfuqishmërinë e vendimit me të cilin është shqiptuar sanksioni për kundërvajtje ndërprerje e vlefshmërisë së patentë shoferit.

(5) Kryerësi të cilit i është shqiptuar sanksion për kundërvajtje ndërprerje e vlefshmërisë së patentë shoferit nga kategori e caktuar, nuk mund të fitojë të drejtën për drejtim të mjetit motorik të kategorisë me të cilën e ka kryer kundërvajtjen për çka i është marrë patenta e shoferit para skadimit të gjashtë muajve nga dita e ndërprerjes së vlefshmërisë së patentë shoferit.

## **Ndalimi për drejtim të mjetit motorik**

### Neni 29

(1) Për kundërvajtje kundër sigurisë në komunikacionin publik, me të cilin është shkaktuar rrezik prej pasojave të rënda, përkatësisht me veprimin ndodh pasojë e dëmshme mund të shqiptohet sanksion për kundërvajtje ndalim për drejtim të mjetit motorik të llojeve të caktuara apo kategorive të mjeteve motorike në kohëzgjatje prej 30 ditë deri në një vit.

(2) Për atë që nuk ka patentë shoferi, kurse kryen kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni, ndalesa për drejtim të mjetit motorik përfshin ndalesë për marrje të patentës së shoferit në periudhë prej 30 ditëve deri në një vit.

(3) Ndalesa për drejtim të mjetit motorik evidentohet në dosjen e shoferit më së voni në afat prej 15 ditëve nga plotfuqishmëria e vendimit dhe fillon të rrjedh nga dita e evidentimit të patentës së shoferit përkatësisht në librezën e shoferit.

(4) Nëse sanksioni për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni do t'i shqiptohet personit i cili ka patentë të huaj për drejtim të mjetit motorik, ky sanksion për kundërvajtje përfshin ndalesë për drejtim të mjetit motorik në territorin e Republikës së Maqedonisë për çka do të njoftohet policia kufitare për shkak të zbatimit të ndalesës.

## **Ndalimi për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës**

### Neni 30

(1) Kryerësit të kundërvajtjes mund t'i ndalohet kryerje e profesionit, veprimtarisë apo detyrës së caktuar apo punë në lidhje me menaxhim, përdorim, menaxhim apo manipulim me pronë apo për ruajtje të asaj prone, nëse e ka keqpërdorur profesionin e vet, veprimtarinë apo detyrën për shkak të kryerjes së kundërvajtjes dhe nëse në bazë të natyrës së kundërvajtjes dhe rrethanave në të cilat është kryer mund të pritët që veprimin e atillë do ta keqpërdor për kryerje të sërishme të kundërvajtjes.

(2) Gjykata e përcakton kohëzgjatjen e ndalesës nga paragrafi (1) i këtij neni, më së gjati deri një vit, duke llogaritur nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit.

(3) Organi për kundërvajtje, sanksionin nga paragrafi (1) i këtij neni mund ta shqiptojë në kohëzgjatje prej së paku tri ditëve deri më së shumti 30 ditë.

## **Dëbimi i të huajit nga vendi**

### Neni 31

(1) Gjykata, kryerësit i cili nuk është shtetas i Republikës së Maqedonisë mund t'i shqiptojë sanksion për kundërvajtje, dëbim nga vendi kur do të vlerësojë se natyra e kundërvajtjes, motivet e kryerësit dhe rrethanat në të cilat është kryer, sugjerojnë në padëshirë për qëndrim të mëtejme të kryerësit në vend.

(2) Dëbimi i shtetasit të huaj nga vendi mund të zgjatë prej një deri në dhjetë vite, apo përgjithmonë dhe fillon të llogaritet nga dita e dëbimit të kryerësit nga territori i Republikës së Maqedonisë.

(3) Sanksioni për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni nuk mund t'i shqiptohet kryerësit që gëzon mbrojtje në pajtim me marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuar në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë.

### **Ndalimi për hyrje apo prezencë në ndeshje sportive**

#### Neni 32

(1) Gjykata do të shqiptojë sanksion për kundërvajtje, ndalesë për hyrje dhe prezencë në ndeshje sportive, nëse është kryer kundërvajtje në rastet e caktuara me ligj.

(2) Ndalesa për hyrje dhe prezencë në ndeshje sportive mund të shqiptohet në kohëzgjatje më së shumti deri tri vite.

### **Ndalimi për shfrytëzim të subvencioneve dhe mjeteve tjera të siguruar nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë**

#### Neni 33

(1) Gjykata do të shqiptojë sanksion për kundërvajtje për shfrytëzim të subvencioneve dhe mjeteve tjera të siguruar prej Buxhetit të Republikës së Maqedonisë, nëse është kryer kundërvajtje në rastet e caktuara me ligj.

(2) Ndalesa për shfrytëzim të subvencioneve dhe mjete tjera të siguruar nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë mund të shqiptohet në kohëzgjatje më së shumti deri tri vite.

#### Kreu i katërt

### **SANKSIONE KUNDËRVAJTËSE PËR PERSONA JURIDIKË**

#### **Lloje të sanksione kundërvajtëse për persona juridikë**

#### Neni 34

Për kundërvajtje personave juridikë mund t'u shqiptohen këto sanksione kundërvajtëse:

- vërejtje,
- gjobë dhe
- ndalim i përkohshëm për kryerjen e veprimtarisë së caktuar.

#### **Vërejtja**

#### Neni 35

Vërejtja shqiptohet për kundërvajtje të kryer në veçanti në rrethana lehtësuese, nëse kundërvajtja përbëhet nga mosplotësimi i obligimit të përcaktuar ose me kundërvajtjen është shkaktuar dëm, ndërsa kryerësi pas miratimit të vendimit për kundërvajtje e ka plotësuar obligimin e caktuar, përkatësisht e ka mënjeluar ose e ka kompensuar dëmin e shkaktuar ose nëse kundërvajtja është kryer për herë të parë dhe nuk ka shkaktuar pasoja të dëmshme për personin e tretë, dhe nuk është rrezikuar interesi publik.

#### **Gjoba**

#### Neni 36

(1) Gjoba për person juridik nuk mund të jetë më e vogël se 50 euro në kundërvlerë me denarë, as më e madhe se 1.000 euro në kundërvlerë me denarë për tregtarë më të vegjël, për tregtarë të vegjël nuk mund të jetë më e vogël se 50 euro në kundërvlerë me denarë, as më e madhe se 2.000 euro në kundërvlerë me denarë, e për tregtarë të mesëm nuk mund të jetë më e vogël se 250 euro në kundërvlerë me denarë, as më e madhe se 6.000 euro në kundërvlerë me denarë dhe për tregtarë të mëdhenj nuk mund të jetë më e vogël se 250 euro në kundërvlerë me denarë, as më e madhe se 10.000 euro në kundërvlerë me.

(2) Për kundërvajtje nga sfera e tatimeve, doganave, prokurimeve publike, financave publike dhe borxhit publik mund të përcaktohet gjobë me shumë më të madhe në para se detyrimi i fshehur ose shuma e furnizimit por më së shumti në shumë të dyfishtë të paragrafit (1) të këtij neni.

(3) Për kundërvajtje në sferën e mbrojtjes së shëndetit të njerëzve, mbrojtjes së pasurisë natyrore, mjedisit jetësor, mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, mund të shqiptohet gjobë me shumë të trefishtë nga gjoba e paraparë në paragrafin (1) të këtij neni.

(4) Për kundërvajtjet e kryera nga lakmia ose për kundërvajtjet me të cilat shkaktohet dëm më i madh pronësor, mund të shqiptohet gjobë deri në shumën e dyfishtë nga maksimumi i këtij sanksioni ose në proporcion me shumën e dëmit të shkaktuar ose dobisë së marrë, por më së shumti deri në shumën e dhjetëfishtë nga paragrafi (1) i këtij neni.

(5) Për kundërvajtjet nga sfera e konkurrencës, komunikimeve elektronike dhe tregtisë me mallra të ndaluara dhe/ose të kufizuara për përdorim, si dhe në sfera të tjera të përfshira me legjislacionin e Bashkimit Evropian mund të shqiptohet gjobë me shumë procentuale, por më së shumti deri 10% nga të hyrat e personit juridikë të realizuar në vitin paraprak fiskal.

(6) Për kundërvajtjet nga sfera e energjetikës mund të përcaktohet gjobë në shumë procentuale, por më së shumti deri në 10% nga të hyrat e personit juridik të realizuara nga veprimtaria enrgjetike, për kryerjen e së cilës ka marrë licencë nga komisioni Rregullator i Energjetikës i Republikës së Maqedonisë, në vitin paraprak fiskal.

(7) Me ligjin me të cilin përcaktohet kundërvajtja, shuma e gjobës shqiptohet në dallim, ndërsa shuma e gjobës në urdhërpagesën kundërvajtëse shqiptohet në shumë fikse.

(8) Në raste kur kryerësi ka shkaqe të arsyeshme për shkak të të cilave gjobën nuk mund ta paguajë menjëherë mund të lejohet që gjoba të paguhet me këste, në mënyrë dhe afat të përcaktuar nga ana e gjykatës përkatësisht organit kundërvajtës.

### **Përcaktimi i gjobës për personin juridik**

#### **Neni 37**

(1) Gjatë përcaktimit të shumës së gjobës të personit juridik, përveç rrethanave të përcaktuara në nenin 16 paragrafi (2) i këtij ligji, gjykata përkatësisht organi kundërvajtës në veçanti i vlerëson si rrethana lehtësuese ose vështirësuese edhe:

- të hyrat e plota të realizuara në vitin paraprak fiskal të vitit në të cilin është kryer kundërvajtja,

- numrin mesatar të të punësuarave në bazë të gjendjes në fund të muajit paraprak lidhur me muajin në të cilin është kryer kundërvajtja dhe sanksionimi paraprak i kryerësit për kundërvajtje të njëjta ose të ngjashme.

(2) Nëse personi juridik në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë nuk ka dorëzuar llogari vjetore për vitin fiskal paraprak prej ku mund të konfirmohen të hyrat e përgjithshme, gjatë përcaktimit të shumës së gjobës do të merren parasysh të hyrat e përgjithshme mesatare në nivel të veprimtarisë të cilën e kryen kryerësi i kundërvajtjes.

(3) Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë dhe Agjencia e Punësimit të Republikës së Maqedonisë janë të obliguar të sigurojnë dhe të dorëzojnë të dhëna të përpunuara për të hyrat e përgjithshme përkatësisht numrin mesatar të të punësuarve, me kërkesë të gjykatës dhe organit kundërvajtës, pa kompensim në afat prej shtatë ditëve nga dita e pranimit të kërkesës.

## **Përmbartimi i gjobës**

### Neni 38

(1) Nëse personi i dënuar juridik nuk e paguan gjobën në afatin e përcaktuar, i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se tetë ditë as më i gjatë se 30 ditë nga dita e plotfuqishmërisë të vendimit, do të zbatohet arkëtim i detyrueshëm, në pajtim me dispozitat e Ligjit për procedurë tatimore.

(2) Gjoha e personave të huaj juridikë përmbartohet nga prona e konfiskuar në Republikën e Maqedonisë ose me zbatimin e marrëveshjes ndërkombëtare të ratifikuar në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, nga prona në vende të huaja.

## **Ndalimi i përkohshëm për kryerjen e veprimtarisë së caktuar**

### Neni 39

(1) Në vendimin me të cilin personit juridik do t'i shqiptohet sanksion kundërvajtës ndalim i përkohshëm për kryerje të veprimtarisë së caktuar, shënohet veprimtaria kryerja e së cilës i ndalohet personit juridik .

(2) Sanksioni kundërvajtës ndalim i përkohshëm për kryerjen e veprimtarisë së caktuar të personit juridik, mund të shqiptohet nëse ekziston rrezik me kryerjen e veprimtarisë së tillë personi juridik të kryejë përsëri kundërvajtje të rrezikshme për jetën ose shëndetin e njerëzve ose kundërvajtje e cila mund t'i shkaktojë dëm pronësor personit tjetër juridik ose qytetarit, nëse personit juridik në dy vitet e fundit i është shqiptuar sanksion kundërvajtës për shkak të kundërvajtjes së njëjtë ose të ngjashme.

(3) Me ligjin me të cilin përcaktohet kundërvajtja, mund të përcaktohet shqiptim i detyrueshëm i sanksionit kundërvajtës ndalim për kryerjen e veprimtarisë së caktuar të personit juridik.

(4) Gjykata e përcakton kohëzgjatjen e sanksionit kundërvajtës nga paragrafi (1) i këtij neni i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se tre muaj as më i gjatë se dy vjet, nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit.

(5) Organi kundërvajtës sanksionin e kundërvajtjes nga paragrafi (1) të këtij neni mund ta shqiptojë në kohëzgjatje prej së paku tri ditë deri më së shumti 30 ditë.

(6) Sanksioni kundërvajtës ndalim i përkohshëm për kryerjen e veprimtarisë nuk mund t'i shqiptohet personit juridik të themeluar me ligj.

### Kreu i pestë

## **MASA TË VEÇANTA TË KUNDËRVAJTJES**

### **Konfiskimi i pronës dhe dobisë pronësore dhe konfiskimi i sendeve**

### Neni 40

(1) Për pronë të konfiskuar dhe dobi pronësore të siguruar me kundërvajtje të personit fizik në mënyrë përkatëse zbatohen dispozitat për konfiskim të pronës dhe dobisë pronësore dhe konfiskimin e sendeve të Kodit penal.

(2) Për pronën e konfiskuar dhe dobinë pronësore të siguruar me kundërvajtje të personit fizik në mënyrë përkatëse zbatohet dispozita për llojet e dënimeve të personit juridik të Kodit penal.

(3) Gjatë konfiskimit të sendeve gjykata përkatësisht organi kundërvajtës në mënyrë përkatëse i zbaton dispozitat për kushtet e konfiskimit të sendeve të Kodit penal.

(4) Organi kundërvajtës nga masat e veçanta kundërvajtëse mund të zbatojë vetëm masën konfiskim i sendeve ose arkëtim i kundërvlerës nga sendet e konfiskuara, kur kjo është e përcaktuar me ligj me të cilin është përcaktuar kundërvajtja.

(5) Nëse organi kontraktues konsideron se për ndonjë kundërvajtje duhet të shqiptohen masat konfiskim i pronës dhe dobisë pronësore, organi do të parashtrorë kërkesë për ngirtjen e procedurës kundërvajtëse me propozim të gjykatës për miratimin e vendimit për kërkesën, me provat e grumbulluara për pronën dhe dobinë pronësore të kundërvajtjes së kryer, pavarësisht nga ajo se kur është parashtruar kërkesa për ngirtjen e procedurës kundërvajtëse para organit.

## Kreu i gjashtë

### PARASHKRIMI DHE EVIDENCA E SANKSIONEVE KUNDËRVAJTËSE

#### **Parashkrimi i ngirtjes dhe udhëheqjes së procedurës kundërvajtëse**

##### Neni 41

(1) Procedura kundërvajtëse nuk mund të ngrihet as të udhëhiqet nëse kalojnë tri vjet nga dita e kur është kryer kundërvajtja.

(2) Për kundërvajtje nga sfera e tatimeve, doganave, prokurimeve publike, financave publike dhe borxhit publik nuk mund të ngrihet as të udhëhiqet procedurë kundërvajtëse nëse kalojnë katër vjet nga dita kur është kryer kundërvajtja.

(3) Për kundërvajtjet nga sfera e konkurrencës, energjetikës, tregtisë me mallra të ndaluara dhe/ose të kufizuara për përdorim, sfera e mbrojtjes së shëndetit të njerëzve, mbrojtjes së pasurisë natyrore, mjedisit jetësor, trashëgimisë kulturore, mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, komunikime elektronike, ose kundërvajtje të shkaktuara nga lakmia, nuk mund të ngrihet as të udhëheqet procedurë kundërvajtëse nëse kalojnë pesë vjet nga dita kur është kryer kundërvajtja.

(4) Parashkrimi i ndjekjes për kundërvajtje fillon nga dita kur është kryer kundërvajtja.

(5) Nëse bëhet fjalë për kundërvajtje të vazhdueshme ose të përsëritur afati i parashkrimit fillon të rrjedhë nga dita e veprimit të fundit të kundërvajtjes.

(6) Parashkrimi nuk rrjedhë gjatë kohës për të cilën sipas ligjit ndjekja nuk mund të fillojë ose të vazhdojë.

(7) Parashkrimi ndërpritet me çdo veprim të procesit që ndërmerret për shkak të ndjekjes së kryerësit të kundërvajtjes.

(8) Parashkrimi ndërpritet edhe kur kryerësi gjatë kohës derisa rrjedh afati i parashkrimit kryen vepër të rëndë kundërvajtëse.

(9) Pas çdo ndërprerje parashkrimi fillon përsëri të rrjedhë.

(10) Parashkrimi për ndjekjen kundërvajtëse shkaktohet në çdo rast kur kalon dyherë aq kohë sa sipas ligjit kërkohet për parashkrim të ndjekjes për kundërvajtje.

(11) Afati i parashkrimi nga paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij neni, mund të jetë më i gjatë nëse në sferë të caktuar kryhet harmonizim me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

#### **Parashkrimi i ekzekutimit të sanksioneve kundërvajtëse**

##### Neni 42

(1) Sanksioni i shqiptuar kundërvajtës nuk mundet të zbatohet nëse nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit për kundërvajtje kanë kaluar tre vjet.

(2) Parashkrimi i ekzekutimit të sanksionit kundërvajtës fillon të rrjedhë prej ditës kur vendimi për kundërvajtje është bërë i plotfuqishëm.

(3) Parashkrimi nuk rrjedh gjatë kohës kur ekzekutimi nuk mund të merret sipas ligjit.

(4) Parashkrimi ndërpritet me çdo veprim të organit kompetent që ndërmerret për shkak të ekzekutimit të sanksionit kundërvajtës.

(5) Pas çdo ndërprerje parashkrimi fillon përsëri të rrjedhë.

(6) Parashkrimi për sanksionin kundërvajtës shkaktohet në çdo rast kur kalon dyherë aq kohe sa sipas ligjit kërkohet për parashkrim të ekzekutimit.

(7) Me këtë ligj me të cilin përcaktohet kundërvajtja, mundet për sanksione të caktuara të përcaktohen afate të parashkrimit për kryerje më të gjata se afati i paragrafit (1) të këtij neni, por jo edhe më të gjata se pesë vjet.

(8) Afati i parashkrimit nga neni 26 paragrafi (7) i këtij ligji fillon të zbatohet pasi skadon afati nga kësti i fundit i pagimit të gjobës.

(9) Afati i parashkrimi nga paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij neni, mund të jetë më i gjatë nëse në sferë të caktuar kryhet harmonizim me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

### **Udhëheqja e evidencës së sanksioneve për kundërvajtje**

#### **Neni 43**

(1) Gjykata dhe organi kundërvajtës mbajnë evidencë për kryerësit e kundërvajtjes dhe për sanksionet e shqiptuara për kundërvajtjen e kryer.

(2) Evidencën për sanksione kundërvajtëse e mban gjykata e shkallës së parë sipas vendlindjes së kryerësit të kundërvajtjes, përkatësisht selisë së personit juridik.

(3) Për personat e lindur në vende të huaja ose për ata që vendlindja është e panjohur, si dhe për personat juridik të huaj, evidencën kundërvajtëse e mban gjykata e caktuar me ligj.

(4) Të dhëna nga evidenca për sanksione kundërvajtëse, gjykata dhe organi kundërvajtës japin vetëm pas kërkesës së arsyetuar nga organet tjera publike, personat fizikë ose juridikë të cilët kanë interes juridik, nëse ende zgjatin masat e ndalesës përkatësisht sanksionet e shqiptuara.

(5) Kryerësit e sanksioneve kundërvajtëse dhe sanksionet e shqiptuara të kundërvajtjes shlyhen nga evidenca e kundërvajtjes pas skadimit të kohës për të cilën janë shqiptuar ose me detyrë zyrtare pas skadimit të një viti nga sanksioni i zbatuar ose sanksioni kundërvajtës i parashkuar.

(6) Përmbajtja dhe mënyra e udhëheqjes së evidencës nga paragrafi (1) i këtij neni për gjykatat e përcakton kryetari i Gjykatës Supreme, ndërsa për organin kundërvajtës ministri i Drejtësisë.

#### **Pjesa e dytë**

### **PROCEDURA PËR BARAZIM DHE MARRËVESHJE**

#### **Kreu i shtatë**

### **QËLLIME DHE MËNYRA E ZBATIMIT TË PROCEDURAVE PËR BARAZIM DHE MARRËVESHJE**

#### **Qëllimi i procedurave për barazim dhe marrëveshje**

#### **Neni 44**

(1) Qëllimi i procedurave për barazim dhe marrëveshje është arritja e pajtimit me kryerësin e kundërvajtjes dhe organeve kompetente të autorizuar për tërheqjen e procedurës kundërvajtëse për mënjanimin e pasojave të dëmshme dhe për shkak të kësaj shmangie të udhëheqjes së procedurës kundërvajtëse para gjykatës kompetente, përkatësisht organit kundërvajtës.

(2) Organet kompetente të autorizuar për ngritjen e procedurës kundërvajtëse janë të obliguar t'i propozojnë kryerësit të kundërvajtjes procedurë për barazim ose marrëveshje para se të parashtrajnë kërkesë për vendosjen e procedurës kundërvajtëse, nëse kjo është e përcaktuar me ligj.

(3) Gjykata përkatësisht organi kontraktues me detyrë zyrtare kujdeset nëse është zbatuar procedura për barazim ose marrëveshje. Nëse nuk është i plotësuar obligimi nga paragrafi (2) i këtij neni, gjykata përkatësisht organi kundërvajtës do ta kthejë kërkesën në organin e paragrafit (2) të këtij neni.

### **Lloje të procedurave**

#### **Neni 45**

(1) Procedura për barazim mbahet si procedurë për lëshimin e urdhërpagesës kundërvajtëse.

(2) Procedura për marrëveshje mbahet si procedurë për marrëveshje me persona fizikë dhe juridikë.

### **Veprime në procedurën për barazim para lëshimit të urdhërpagesës kundërvajtëse**

#### **Neni 46**

(1) Kur personi i autorizuar zyrtar do të konstatojë kundërvajtje përpilon procesverbal në të cilin i shënon elementet e rëndësishme të veprimit prej ku del shenja juridike e kundërvajtjes, emrin personal, adresa dhe numri personal i qytetarit, nëse bëhet fjalë për të huaj, numri i dokumentit të udhëtimit dhe shteti, ndërsa për personin juridik, emri, selia dhe numri tatimor, koha, vendi dhe mënyra e kryerjes së kundërvajtjes, përshkrimi i veprimit, kualifikimi juridik i kundërvajtjes dhe personat e hasur në vendin e ngjarjes, si dhe jep propozime për barazim me lëshimin e urdhërpagesës kundërvajtëse. Procesverbalin e nënshkruan personi i autorizuar zyrtar dhe kryerësi.

(2) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, nëse personi i autorizuar zyrtar kundërvajtjen e konfirmon personalisht ose e konfirmon me përdorimin e mjeteve përkatëse teknike dhe vegla, përkatësisht me të dhënat e evidencës zyrtare procesverbalin e nënshkruan vetëm personi i autorizuar zyrtar.

(3) Nëse në procedurë kryerësit i është lëshuar urdhërpagesë kundërvajtëse këtë do ta shënojnë në procesverbalin e kundërvajtjeve të konstatuara.

(4) Nëse kryerësi nuk pajtohet që t'i lëshohet urdhërpagesë kundërvajtëse ose me ligj nuk është përcaktuar lëshimi i urdhërpagesës kundërvajtëse, e njëjta do të shënohet në procesverbalin e kundërvajtjeve të konstatuara, ndërsa personi i autorizuar zyrtar dorëzon kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse para organit kompetent përkatësisht organit kundërvajtës.

### **Lëshimi i urdhërpagesës kundërvajtëse**

#### **Neni 47**

(1) Kur personi i autorizuar zyrtar do të konfirmojë se është kryer kundërvajtje për të cilën me ligj është paraparë lëshimi i urdhërpagesës kundërvajtëse, kryerësit të kundërvajtjes do t'ia kthejë urdhërpagesën kundërvajtëse.

(2) Në urdhërpagesën kundërvajtëse janë cekur elementet e rëndësishme të veprimit prej ku del shënimi juridik i kundërvajtjes, emri, adresa dhe numri personal i qytetarit, nëse bëhet fjalë për të huaj edhe numri i dokumentit të udhëtimit dhe shteti, ndërsa për personin juridik, emri, selia dhe numri tatimor, vendi dhe koha e shaktimit të kundërvajtjes, kualifikimi juridik i kundërvajtjes së gjobës, numri i llogarisë së pagesës, mendimi juridik si dhe të dhëna të tjera në pajtim me ligjin.



(3) Në procedurën e barazimit, gjoba në urdhërpagesën kundërvajtëse shqiptohet në shumë fikse të përcaktuar me ligj, ndërsa gjoba është e përcaktuar ndryshe shqiptohet shuma minimale e përcaktuar për kundërvajtje.

(4) Pas pranimit të urdhërpagesës kundërvajtëse kryerësi është i obliguar ta paguajë gjobën e shqiptuar në pajtim me paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni në afat prej tetë ditëve nga dita e pranimit të urdhërpagesës kundërvajtëse në llogarinë e shënuar në urdhërpagesën kundërvajtëse.

(5) Kryerësi i cili do ta paguajë gjobën në afatin nga paragrafi (4) i këtij neni do të paguajë gjysmën e gjobës së shqiptuar, për këtë të drejtë këshillohet në këshillën juridike.

(6) Në procedurën e cila do të kryhet me pagimin e urdhërpagesës kundërvajtëse nuk paguhen harxhimet e procedurës.

(7) Kryerësi i cili me shkuarjen për qëndrim në vend të huaj do të mund ta shmangë, është i obliguar menjëherë ta paguajë gjobën e shqiptuar me urdhërpagesë kundërvajtëse.

(8) Nëse kryerësi nuk e paguan gjobën në afatin nga paragrafët (4) dhe (7) të këtij neni, personi i autorizuar zyrtar paraqet kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse në gjykatën kompetente përkatësisht organin kundërvajtës.

(9) Organi kompetent për ngritjen e procedurës kundërvajtëse mundet përkohësisht t'ia heq dokumentet e udhëtimit ose letërnjoftimin personit të huaj dhe patentë shoferin, derisa nuk dorëzohet provë se gjoba është e paguar, por më së voni tetë ditë nga dita e heqjes së dokumentit të udhëtimit ose letërnjoftimit të personit të huaj dhe patentë shoferin.

### **Procedura e marrëveshjes me persona fizikë dhe juridikë**

#### **Neni 48**

(1) Procedura për marrëveshje mund të mbahet për kundërvajtje nga sfera e tatimeve, doganave, prokurimeve publike, financave publike dhe borxhit publik, konkurrenca, energjetika, tregtia me përdorimin e mallrave të ndaluara ose të përkufizuara për përdorim, mbrojtje të shëndetit të njerëzve, mbrojtja e pasurisë natyrore, mjedisit jetësor, mbrojtja e trashëgimisë kulturore, mbrojtja nga fatkeqësitë natyrore dhe të tjera, komunikime elektronike ose për kundërvajtje të kryera nga lakmia.

(2) Për kundërvajtjet kur ajo është e përcaktuar me ligj, organi i cili është kompetent për vendosjen e procedurës kundërvajtëse, do të përpilojë procesverbal për kundërvajtje të konstatuar dhe të njëjtit do t'i propozohet kryerësit të kundërvajtjes marrëveshje dhe arritje të pëlqimit me të cilin kryerësi i kundërvajtjes do ta paguajë gjobën e kontraktuar dhe të dhënat tjera të përcaktuara me ligj, do t'i mënjanojë pasojat e kundërvajtjes ose do ta plotësojë ndonjë obligim të paraparë me ligj.

(3) Personi i autorizuar zyrtar përpilon procesverbal në të cilin konstatohet pajtueshmëria për marrëveshje për të dyja palët në të cilën nënshkruan edhe kryerësi i kundërvajtjes dhe në afat prej tri ditëve nga nënshkrimi i procesverbalit e dorëzon në komisionin për marrëveshje.

(4) Procedura e marrëveshjes është urgjente dhe mbahet para komisionit të veçantë për marrëveshje në kuadër të organit kompetent, pavarësisht nga shuma e paraparë e gjobës.

(5) Nëse procedura e marrëveshjes ka sukses në afat prej 30 ditëve nga dita e fillimit të procedurës para komisionit për marrëveshje, lidhet marrëveshje me kryerësin e kundërvajtjes.

(6) Nëse procedura për marrëveshje nuk arrihet, komisioni për marrëveshje në afat prej tri ditëve nga dita e përfundimit të procedurës për marrëveshje e informon organin kompetent i i cili e ka konstatuar marrëveshjen, të paraqetë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse para gjykatës ose organit kundërvajtës, ndërsa harxhimet e procedurës janë në ngarkim të kryerësit.

(7) Marrëveshja për gjobën e kontraktuar e cila nuk mundet të jetë më e vogël se gjysma e gjobës fikse të përcaktuar ose gjysmën e minimumit të përcaktuar kur gjoba është e përcaktuar në shtrirje, ka fuqi të dokumentit përmbarues. Nëse kryerësi nuk e paguan gjobën në afatin e përcaktuar, ajo do të dorëzohet në organin e administratës kompetente për arkëtim të detyrueshëm.

Pjesa e tretë

PROCEDURA KUNDËRVAJTËSE

Kreu i tetë

DISPOZITA THEMELORE

**Kompetenca për kundërvajtje**

Neni 49

(1) Procedurë kundërvajtëse mund mbajë edhe sanksion kundërvajtës mund të shqiptojë vetëm gjykata kompetente.

(2) Për kundërvajtje të caktuara për të cilat gjoba është e përcaktuar deri më së shumti 250 euro në kundërvlerë me denarë për persona fizikë, 500 euro në kundërvlerë me denarë për persona përgjegjës në persona juridikë dhe persona zyrtar dhe 1000 euro në kundërvlerë me denarë për persona juridikë, procedurën kundërvajtëse mund ta mbajë edhe sanksion kundërvajtës dhe mund t'i shqiptojë organi kundërvajtës dhe personi i autorizuar zyrtar.

(3) Me përjashtim të paragrafit (2) të këtij neni, procedurë kundërvajtëse mund të mbajë edhe sanksion kundërvajtës mund të shqiptojë organi kundërvajtës për të cilat është paraparë gjobë më e lartë se ajo e përcaktuar në paragrafin (2) të këtij neni, nëse kjo është e paraparë me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

(4) Procedurën kundër personit përgjegjës në personin juridik e mban gjykata përkatësisht organi kundërvajtës i cili është kompetent për mbajtjen e procedurës kundërvajtëse për personin juridik.

(5) Të gjitha organet publike dhe bartësit e autorizimeve publike janë të obliguar që gjykatës dhe organit kundërvajtës t'i dorëzojnë ndihmë të nevojshme falas dhe të dhënat e nevojshme për përcaktimin e fakteve lidhur me procedurën kundërvajtëse dhe ekzekutimin e sanksioneve.

**Konflikti i kompetencave**

Neni 50

(1) Për konfliktin e kompetencave mes gjykatave dhe organeve kundërvajtëse vendos Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë.

(2) Procedurë për zgjidhjen e konfliktit të kompetencave ngrit organi kundërvajtës përkatësisht gjykata e cila me vendimin e saj shkakton konflikt të kompetencave.

**Imuniteti**

Neni 51

Procedurë kundërvajtëse nuk do të udhëheqet kundër personit i cili ka imunitet diplomatik, si dhe kundër personave të tjerë të cilët kanë imunitet në pajtim me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë dhe nën kushte të reciprocitetit.

**Vendimi**

Neni 52

Për kundërvajtje dhe për shqiptimin e kundërvajtjes vendosin gjykata, përkatësisht organi kundërvajtës me vendim, kundër të cilit janë lejuar mjete juridike të përcaktuara me këtë ligj.

## **Harxhime të procedurës**

### Neni 53

Harxhime të procedurës janë harxhime të cilat janë shkaktuar në procedurë kundërvajtëse ose për shkak të saj dhe harxhime që do të shkaktohen lidhur me sigurimin e provave të nevojshme dhe ruajtjes të sendeve të konfiskuara para ngritjes së procedurës.

### Pjesa e katërt

## **PROCEDURA KUNDËRVAJTËSE PARA ORGANIT KUNDËRVAJTËS**

### Kreu i nëntë

## **DISPOZITA TË PËRGJITHSHME DHE RRJEDHA E PROCEDURËS**

### **Kompetenca e organit kundërvajtës**

#### Neni 54

(1) Organi kundërvajtës mban procedurë kundërvajtëse kur me ligj është e përcaktuar kompetencë ekskluzive për veprimin e tij.

(2) Për udhëheqjen e procedurës kundërvajtëse kundër personit juridik kompetent është organi kundërvajtës ku gjendet selia e personit juridik, përkatësisht selia e personit të huaj juridik, nëse me ligj të veçantë nuk është ndryshe e përcaktuar.

### **Autorizimi për udhëheqjen e procedurës**

#### Neni 55

(1) Procedurën para organit kundërvajtës e udhëheq Komisioni për vendimmarrje për kundërvajtje i përcaktuar me ligj.

(2) Anëtarët e Komisionit nga paragrafi (1) i këtij neni janë persona të autorizuar zyrtar me shkallën përkatëse dhe llojin e përgatitjes profesionale dhe përvojën e nevojshme të punës të përcaktuar me ligj, prej ku më së paku njëri nga anëtarët është jurist i diplomuar me provimin e dhënë të jurisprudencës.

(3) Punët profesionale - administrative për Komisionin nga paragrafi (1) i këtij neni, i kryejnë persona në organin në pajtim me aktin e sistematizimit të vendeve të punës.

### **Dorëzimi i shkresave personave fizikë**

#### Neni 56

(1) Shkresat dorëzohen me postë, përmes personit juridik me autorizime të veçanta të përcaktuara me ligj, përmes personit zyrtar të organit kundërvajtës ose drejtpërdrejt në organin kundërvajtës.

(2) Kur dërgesa bëhet me postë, me dërgesë të rekomanduar ose përmes personit juridik me autorizime të veçanta të përcaktuara me ligj, dërgesa llogaritet e kryer në ditën kur me shkrim do t'i kthehet në adresë personit të cilit ajo ia dërgon, përkatësisht nëse personi nuk e merr shkresën në afat prej tetë ditëve nga dita e dorëzimit dorëzohet lajmërim edhe pse ka qenë i thirrur këtë ta bëjë.

(3) Nëse personi nuk gjendet aty ku duhet të kryhet dorëzimi, dorëzuesi do t'i dorëzojë ndonjë anëtar të familjes më i vjetër se 16 vjet, i cili detyrohet ta pranojë shkresën ose shkresën do t'ia dorëzojë kujdestarit ose fqinjët, nëse ata pajtohen që ta pranojnë. Dorëzimi i shkresave për të paraburgosurit ose personat e gjykuar me dënim me burg bëhet përmes institucionit ku janë të vendosur.

(4) Nëse konfirmohet se personi mungon dhe për këtë shkak personat nga paragrafi (3) nuk munden në kohë t'ia dorëzojnë, shkresa do të kthehet me shënim se ku gjenet personi që mungon.

(5) Organi kundërvajtës është i obliguar në periudhë prej 15 ditësh nga dita e llogaritjes kur duhet të konfirmohet nevoja për dorëzim, të bëhen dy tentime të një pas njëshme që të kryhet sipas rregullës dorëzimi në njërën nga mënyrat e parapara në paragrafin (1) të këtij neni, nëse dërgesa nuk arrin, shkresa publikohet në ueb faqen e organit kundërvajtës dhe me skadimin e tetë ditëve nga publikimi i tij llogaritet se dërgesa është kryer.

### **Dorëzimi i shkresave personave juridikë**

#### **Neni 57**

(1) Dorëzimi i shkresave personave juridik bëhet në formë elektronike, në pajtim me nenin 82 të këtij ligji.

(2) Nëse nuk ekzistojnë kushte për zbatim të paragrafit (1) të këtij neni, dërgesat bëhen me postë, përmes personit juridik me autorizime të veçanta të përcaktuara me ligj, përmes personit zyrtar të organit kundërvajtës ose drejtpërdrejt në organin kundërvajtës.

(3) Kur dërgesa bëhet me postë, me dërgesë të rekomanduar në adresën e personit juridik të cilit i dorëzohet ose përmes personit juridik me autorizime të veçanta të përcaktuara me ligj, dërgesa llogaritet e kryer në ditën e dorëzimit të shkresës në sekretarinë e personit juridik, përkatësisht nëse personi nuk e merr shkresën në afat prej tetë ditëve nga dita e dorëzimit të lajmërimit edhe pse ka qenë i ftuar ta bëjë këtë.

(4) Kur dërgesa kryhet përmes personit zyrtar të organit kundërvajtës, organi kundërvajtës është i obliguar në periudhë prej 15 ditësh llogaritur nga dita kur duhet të konfirmohet nevoja për dorëzim, të bëhen dy tentime të një pas njëshme të kryhet sipas rregullës dorëzimi në njërën nga mënyrat e parapara në paragrafin (2) të këtij neni, nëse dërgesa nuk arrin, shkresa publikohet në ueb faqe e organit kundërvajtës dhe me skadimin e tetë ditëve nga publikimi i tij llogaritet se dërgesa është kryer.

### **Ngritja e procedurës kundërvajtëse**

#### **Neni 58**

(1) Organi kundërvajtës ngre procedurë kundërvajtëse me detyrë zyrtare ose me kërkesë nga personi i autorizuar në organin e nenit 83 paragrafi (2) të këtij ligji.

(2) Personi i autorizuar zyrtar nga paragrafi (1) i këtij neni është i obliguar në afat sa më të shkurtër të mundshëm jo më gjatë se 30 ditë nga dita pas konstatimit të kundërvajtjes ose pas kërkesës së ngritur për kundërvajtje të kryer, të paraqesë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse çdo herë kur ekziston bazë ligjore për atë, kur është e konfirmuar me mjete teknike ose me kallëzim të personit të dëmtuar.

(3) Nëse afati i paragrafit (2) të këtij neni ka skaduar ose është marrë njoftim nga organi kundërvajtës se kërkesa është e pabazuar, i dëmtuari ka të drejtë të parashtojë kundërshtim deri te organi më i lartë kompetent për kryerjen e mbikëqytjes mbi punën e personit të autorizuar zyrtar, vendimi i të cilit është përfundimtar.

(4) I dëmtuari nëse ka kërkesë juridike pronësore mund ta realizojë të njëjtën në procedurë kontestimore.

(5) Kërkesa për ngritjen e procedurës kundërvajtëse i përmban të dhënat e nenit 84 të këtij ligji.

(6) Kërkesa dorëzohet në organin kompetent kundërvajtës. Nëse kërkesa është e dorëzuar në organin tjetër, ai menjëherë do ta kalojë në organin kompetent kundërvajtës dhe për të do ta informojë parashtruesin e kërkesës.

(7) Nëse me pranimin e kërkesës nga paragrafi (2) të këtij neni ose gjatë procedurës organi kundërvajtës e konstaton se nuk është kompetent real në pajtim me këtë ose me ndonjë ligj tjetër të veprorë sipas kundërvajtjes, përkatësisht se kundërvajtja është në kompetencë të gjykatës, me vendim do të shpallet si jokompetent dhe kërkesa për ngritjen e procedurës kundërvajtëse me të gjitha shkresat do ta dorëzojë në gjykatën kompetente.

(8) Organi kundërvajtës me vendim do ta hedh poshtë kërkesën për ngritjen e procedurës kundërvajtëse në pajtim me nenet 86 dhe 87 të këtij ligji.

(9) Vendimin nga paragrafi (8) i këtij neni do ta dorëzojë tek parashtruesi i kërkesës në afat prej pesë ditëve nga dita e miratimit.

### **Procedura e shkurtuar**

#### **Neni 59**

(1) Organi kundërvajtës mban procedurë të shkurtuar kur:

- në kërkesën për ngritjen e procedurës kundërvajtëse janë përmbajtur të gjitha faktet dhe provat në bazë të të cilave mund të vendoset pa praninë e kryerësit të kundërvajtjes,
- kërkesa për vendosjen e procedurës bazohet në dokumente publike të lëshuara nga organet kompetente publike dhe
- kryerësi është hasur gjatë kryerjes së kundërvajtjes nga ana e personit të autorizuar zyrtar.

(2) Në procedurën e shkurtuar vendoset pa hetimin e kryerësit kur ai është thirrur sipas rregullës, dhe nuk paraqitet dhe nuk dorëzon provë për pengesën e arsyeshme të paraqitet para organit kundërvajtës.

### **Procedura para organit kundërvajtës**

#### **Neni 60**

(1) Organi kundërvajtës me detyrë zyrtare pa prolongim i grumbullon provat dhe e përcakton gjendjen faktike të nevojshme për vendimmarrje për kundërvajtjen.

(2) Nëse kryerësi i kundërvajtjes është i huaj procedura është urgjente dhe e njëjta përfundon në afat prej më së shumti tri ditë.

(3) Organi kundërvajtës para miratimit të vendimit për kundërvajtje, detyrimisht do ta informojë kryerësin e kundërvajtjes që i vihet në barrë dhe e këshillon se në afat prej tri ditëve nga pranimi i njoftimit ka të drejtë të prononcohet për faktet dhe provat.

(4) Me përjashtim të paragrafit (3) të këtij neni, për kundërvajtje të veçanta të përcaktuara me ligj mund të përcaktohet edhe afat më i gjatë për prononcim, nëse me ligj nuk parashihen afate më të gjata për prononcim.

(5) Organi kundërvajtës mund ta thërras kryerësin e kundërvajtjes në organ që gojarisht të prononcohet për faktet dhe provat.

(6) Nëse kryerësi i kundërvajtjes e pranon veprën e kundërvajtjes dhe pranimi është i qartë dhe i plotë, organit kundërvajtës nuk i nevojitet të grumbullojë edhe prova të tjera.

(7) Organi kundërvajtës për bashkim dhe ndarje të procedurës vendos sipas dispozitave të nenit 88 të këtij ligji.

### **Debat gojor**

#### **Neni 61**

Organi kundërvajtës mund të mbajë debat gojor sipas dispozitave të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative.

## **Përmbajtja e aktvendimit**

### **Neni 62**

(1) Aktvendimi për kundërvajtje përmban hyrje, dispozitiv, arsyetim dhe këshillë juridike.

(2) Hyrja e vendimit për kundërvajtje e përmban emrin e organit kundërvajtës i cili e ka miratuar, emrin dhe mbiemrin e anëtarëve të Komisionit nga neni 55 të këtij ligji, emrin dhe mbiemrin e kryerësit dhe mbrojtësit, emrin dhe mbiemrin e personit përgjegjës në personin juridik, firmën përkatësisht emrin dhe selinë e personit juridik dhe kundërvajtjen që është lëndë e procedurës.

(3) Dispozitivi i vendimit për kundërvajtje doemos duhet të përmbajë: të dhëna bazë për identitetin e kryerësit (emri dhe mbiemri, nofkë, numri unik amë i qytetarit ( në tekstin e mëtejme: NUAQ), vendi dhe datëlindja, vendbanimi, rruga dhe numri, adresa e qëndrimit të përkohshëm, profesioni, shtetësia, nëse personi fizik është i huaj, atëherë në vend të NUAQ numrin e dokumentit të udhëtimit), për personin juridik emri dhe selia e personit juridik, numri unik tatimor (në tekstin e mëtejme: NUT), ndërsa për personin përgjegjës në personin juridik edhe funksionin që e kryen në personin juridik: përshkrimin faktik të kundërvajtjes se kryerësi e ka kryer kundërvajtjen, sanksioni kundërvajtës që shqiptohet, masa e veçantë e kundërvajtjes nëse është e shqiptuar ose procedura është e ndërpresë, si dhe paralajmërim se gjoba e papaguar do të arkëtohet me detyrim, si dhe harxhimet e procedurës.

(4) Arsyetimi i vendimit duhet të jetë i kuptueshëm dhe të përmbajë: fjalim të shkurtër të parashtruesit të kërkesës për ngritjen e procedurës kundërvajtëse, faktet e përcaktuara sipas të cilës është dorëzues kërkesa, dispozitat juridike dhe shkaqet për të cilat është miratuar vendimi, shkaqet për shkak të cilave disa nga kërkesat, pohimet ose propozime e dorëzuesit të kërkesës nuk janë pranuar, si dhe shkaqet për të cilat disa nga deklaratat e dhëna gjatë procedurës nuk janë marrë parasysh.

(5) Aktvendimi për kundërvajtje doemos duhet të ketë këshillë juridike.

## **Aktvendimi për përcaktimin e kundërvajtjes**

### **Neni 63**

(1) Organi kundërvajtës do të miratojë aktvendim për kundërvajtje me të cilin do të përcaktohet përgjegjësia e kryerësit dhe i shqiptohet sanksion kundërvajtës.

(2) Aktvendimi për kundërvajtje ka të bëjë vetëm me personin për të cilin kërkohet ngritja e procedurës kundërvajtëse dhe vetëm për kundërvajtjen që është lëndë e kërkesës.

(3) Organi kundërvajtës nuk është i lidhur për propozimet dhe vlerësimin lidhur me kualifikimin juridik të kundërvajtjes.

(4) Vendimi për kundërvajtje bazohet në provat dhe faktet e përcaktuara në procedurën kundërvajtëse.

(5) Nëse procedura kundërvajtëse mbahet për më shumë kundërvajtje, në aktvendim do të ceket se për cilat kundërvajtje është përcaktuar përgjegjësia dhe cili sanksion kundërvajtës i shqiptohet.

(6) Aktvendimi i miratuar në procedurë të shkurtuar, kur kryerësi e ka pranuar kundërvajtjen dhe heq dorë nga e drejta e mjetit juridik të rregullt nuk ka arsyetim.

## **Aktvendimi me të cilin kryerësi lirohet nga përgjegjësia**

### **Neni 64**

Gjatë miratimit të aktvendimit me të cilin kryerësi lirohet nga përgjegjësia, organi kundërvajtës në mënyrë përkatëse do t'i zbatojë dispozitat nga neni 114 pikat prej 1 deri në 10 të këtij ligji.

## **Aktvendimi për ndalimin dhe ndërprerjen e procedurës**

### **Neni 65**

(1) Gjatë miratimit të aktvendimit me të cilin ndërpritet procedura, organi kundërvajtës në mënyrë përkatëse do t'i zbatojë dispozitat e neneve 102 dhe 115 të këtij ligji.

(2) Gjate miratimit të aktvendimit me të cilin ndërpritet procedura, organi kundërvajtës në mënyrë përkatëse do t'i zbatojë dispozitat e nenit 101 të këtij ligji.

### **Vërejtja**

### **Neni 66**

(1) Organi kundërvajtës në vend të shqiptimit të gjobës për kryerësin e kundërvajtjes shqipton vërejtje në bazë të neneve 24 dhe 35 të këtij ligji.

(2) Organi kundërvajtës sipas rregullës shqipton kundërvajtje kur kundërvajtja është kryer në rrethana veçanërisht lehtësuese, nëse kundërvajtja përbëhet nga mosplotësimi i obligimit të përcaktuar ose me kundërvajtjen është shkaktuar dëm, ndërsa kryerësi pas miratimit të vendimit për kundërvajtje e ka plotësuar obligimin e caktuar, përkatësisht e ka mënjeluar ose e ka kompensuar dëmin e shkaktuar ose nëse kundërvajtja është kryer për herë të parë dhe nuk ka shkaktuar pasoja të dëmshme për personin e tretë, dhe nuk është rrezikuar interesi publik.

### **Harxhime të procedurës**

### **Neni 67**

(1) Harxhimet në procedurë i paguan kryerësi i kundërvajtjes, të cilit i është shqiptuar sanksion kundërvajtës.

(2) Nëse për përcaktimin e harxhimeve nuk ka të dhëna të mjaftueshme, për harxhimet e procedurës do të miratohet aktvendim i veçantë.

(3) Shuma dhe mënyra e përcaktimit të harxhimeve të bëra reale në procedurën kundërvajtje para organit kundërvajtës i përcakton ministri i Drejtësisë.

### **Procedura pas mjeteve juridike kundër aktvendimit të organeve kundërvajtje**

### **Neni 68**

(1) Kundër aktvendimit për kundërvajtje që e ka miratuar organi kundërvajtës mund të paraqitet ankesë në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit përmes organit kontraktues në Komisionin shtetëror për vendimmarrje në shkallë të dytë në sferën e mbikëqyrjes inspektuese dhe procedurës kundërvajtëse, të themeluar me ligj të veçantë në tekstin e mëtejme Komisioni shtetëror).

(2) Ankesë nga paragrafi (1) i këtij neni mund të paraqesë personi (fizik ose juridik) të cilit i është shqiptuar sanksion kundërvajtës, përfaqësuesi i tij ligjor, përkatësisht mbrojtësi, i dëmtuari ose përfaqësuesi i tij, pronari i sendeve të konfiskuara në procedurën kundërvajtëse dhe parashtruesi i kërkesës për ngritjen e procedurës kundërvajtëse.

(3) Nëse organi kundërvajtës që e ka miratuar aktvendimin konstaton që ankesa ka bazë, dhe nuk është e nevojshme të zbatohet procedurë e re, mund të vendos ndryshe dhe me vendim të ri ta zëvendësojë vendimin që rrëzohet me ankesën.

(4) Ankesa nga paragrafi (1) i këtij neni e shtynë realizimin e aktvendimit, përveç kur ankesa është e parashtruar nga person i huaj.

(5) Kundër aktvendimit për ankesë që e ka miratuar Komisioni shtetëror mund të paraqitet padi për ngritjen e kontestit administrativ. Padi mund të paraqesë personi (fizik ose juridik) të cilit i është shqiptuar sanksion kundërvajtës, përfaqësuesi i tij ligjor, përkatësisht mbrojtësi, i dëmtuari ose përfaqësuesi i tij, pronari i mjeteve të konfiskuara në procedurën kundërvajtëse dhe parashtruesi i kërkesës për ngritjen e procedurës kundërvajtëse.

(6) Padia nga paragrafi (5) i këtij neni e prolongon realizimin e aktvendimit.

(7) Gjykata kompetente që të vendos për kontest administrativ procedurën e mbrojtjes gjyqësore e udhëheq sipas Ligjit për konteste gjyqësore.

### **Arsyet për rrëzimin e aktvendimit të Komisionit Shtetëror**

#### **Neni 69**

Vendimi i Komisionit Shtetëror mund të rrëzohet:

- nëse është miratuar nga organ jokompetent,
- për zbatim të gabuar të të drejtës materiale,
- për shkak të gjendjes faktike të përcaktuar të gabuar ose jo të plotë në procedurë e cila i ka paraprirë aktit,
- kur në procedurën e cila i ka paraprirë aktit nuk është vepruar sipas rregullave të procedurës dhe
- për shkak të përcaktimit të padrejtë dhe shqiptimit të sanksionit kundërvajtës.

### **E drejta e ngritjes së kontestit administrativ**

#### **Neni 70**

(1) Kundër aktvendimit për kundërvajtje mund të paraqitet padi për ngritjen e kontestit administrativ në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit.

(2) Padi mund të parashtrë personi ( fizik ose juridik) të cilit i është shqiptuar sanksion kundërvajtës, përfaqësuesi i tij ligjor, mbrojtësi dhe pronari i sendeve të konfiskuara në procedurë kundërvajtëse.

(3) Nëse organi kundërvajtëse që e ka miratuar aktvendimin kur do t'i dorëzohet padi ndaj përgjigjes konstaton se e njëjta është e bazuar, kurse nuk është e nevojshme të zbatohet procedurë e re, mund të vendosë ndryshe dhe me vendim të ri ta zëvendësojë vendimin që rrëzohet me padinë.

(4) Organi kundërvajtës nga paragrafi (3) i këtij neni menjëherë e informon gjykatën kompetente për vendimmarrje për kontest administrativ, i cili me aktvendim e ndërpret procedurën.

(5) Padia nga paragrafi (1) e këtij neni e shtyn zbatimin e aktvendimit.

(6) Gjykata kompetente për vendosje për kontestin administrativ procedurën e mbrojtjes gjyqësore e mban sipas Ligjit për konteste administrative.

### **Konfiskimi i përkohshëm i sendeve**

#### **Neni 71**

(1) Me ligj mund të autorizohen personat zyrtarë në organet e administratës shtetërore ose organizatat dhe organet tjera që kryejnë autorizime publike të mbikëqyrjes mbi zbatimin e ligjeve, përkohësisht t'i marrin sendet nga neni 40 i këtij ligji, kur në kryerjen e detyrave zyrtare do të kuptojnë për kundërvajtjen dhe t'i dorëzojnë ato te Agjencia për Menaxhim me Pronë të Konfiskuar.



(2) Personat e autorizuar zyrtarë nga paragrafi (1) i këtij neni janë të obliguar që në afat prej 15 ditëve nga dita e marrjes së sendeve të paraqesin kërkesë për fillimin e procedurës kundërvajtëse në gjykatën kompetente përkatësisht në organin kundërvajtës dhe t'i njoftojnë për marrjen e përkohshme të sendeve.

(3) Nëse personat e autorizuar zyrtarë nga paragrafi (1) i këtij neni nuk veprojnë në pajtim me paragrafin (2) të këtij neni, gjykata ose organi kundërvajtës në bazë të kërkesës së paraqitur nga personi prej të cilit janë marrë sendet do të miratojë vendim për kthimin e sendeve, përveç sendeve qarkullimi i të cilave është i ndaluar.

### **Ndalimi i përkohshëm për kryerjen e veprimtarisë**

#### **Neni 72**

(1) Personat e autorizuar zyrtarë në organet e administratës shtetërore ose organizatat dhe organet tjera që kryejnë autorizime publike për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve, në rastet e përcaktuara me ligj, kryerësit të kundërvajtjes mund t'i ndalojnë përkohësisht kryerje të veprimtarisë me të cilën është kryer kundërvajtja nëse ekziston rreziku i përsëritjes së kundërvajtjes ose për mënjanimin e pasojave nga kundërvajtja dhe janë të detyruar të paraqesin kërkesë për fillimin e procedurës kundërvajtëse në afat prej 15 ditësh nga dita e konstatimit të kundërvajtjes.

(2) Nëse kërkesa nuk paraqitet në afatin nga paragrafi (1) i këtij neni konsiderohet se Mbajtja e përkohshme ka pushuar të vlejë.

#### **Pjesa e pestë**

### **PROCEDURA KUNDËRVAJTËSE PARA GJYKATËS**

#### **Kreu i dhjetë**

#### **Dispozitat e përgjithshme**

### **Kompetenca reale**

#### **Neni 73**

(1) Procedurën kundërvajtëse në shkallë të parë e mban gjykatësi individual në gjykatën themelore, ndërsa procedurën për mjetet e rregullta juridike këshilli nga tre gjykatës në gjykatat e apelit.

(2) Procedurën kundërvajtëse gjatë kërkesës së parashtruar për mbrojtjen e ligjshmërisë e udhëheq këshilli nga tre gjykatës pranë Gjykatës Supreme.

(3) Procedurën kundërvajtëse për kërkesën e paraqitur për përsëritjen e procedurës e mban këshilli penal nga tre gjykatës në gjykatën themelore.

(4) Në procedurën kundërvajtëse për kthimin në gjendjen e mëparshme, vendos gjykatësi i gjykatës themelore që ka miratuar vendimin paraprak.

### **I akuzuari**

#### **Neni 74**

(1) I akuzuari sipas këtij ligji, është person fizik ose juridik kundër të cilit mbahet procedurë kundërvajtëse.

(2) Nëse për kundërvajtje është akuzuar person juridik dhe personi përgjegjës te personi juridik zbatohet procedurë e vetme.

## **Përfaqësimi i personit juridik**

### Neni 75

(1) Për personin juridik të akuzuar në procedurë kundërvajtëse merr pjesë përfaqësuesi i tij, i autorizuar për të ndërmarrë të gjitha veprimet që mund të ndërmerren nga i akuzuari në pajtim me këtë ligj.

(2) Përfaqësuesi i personit juridik të akuzuar është person i autorizuar për të përfaqësuar personin juridik në bazë të ligjit ose dispozite tjetër të organi kompetent, statut ose akt tjetër të përgjithshëm të personit juridik.

(3) Kur personi juridik është themeluar nga një themelues, atëherë i njëjti person do të konsiderohet si personi përgjegjës dhe përfaqësues i personit juridik.

(4) Organi kompetent i personit juridik të akuzuar mund të caktojë përfaqësues të përcaktojë person tjetër i cili është i punësuar në atë person juridik.

(5) Përfaqësuesi i personit juridik të akuzuar nga paragrafi (4) i këtij neni është i detyruar të ketë autorizim me shkrim nga organi kompetent që e ka caktuar atë si përfaqësues.

(6) Përfaqësues i personit juridik të akuzuar mund të jetë vetëm një person.

## **Përfaqësimi i personit juridik të huaj**

### Neni 76

Personin juridik të huaj e përfaqëson udhëheqësi i filialit respektivisht i përfaqësisë së personit tjetër juridik të autorizuar nga personi juridik i huaj.

## **Kufizimi i përfaqësimit**

### Neni 77

(1) Përfaqësues i personit juridik të akuzuar, përveç personit nga neni 75 paragrafi (3) të këtij ligji, nuk mund të jetë personi përgjegjës në personin juridik kundër të cilit mbahet procedurë kundërvajtëse për kundërvajtjen e njëjtë.

(2) Përfaqësuesi i personit juridik nuk mund të jetë person i cili është dëshmitar në punën e njëjtë.

(3) Në rastet nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, gjykata është e detyruar ta informojë personin juridik për përcaktimin e përfaqësuesit tjetër.

(4) Për person juridik të huaj, njoftimi nga paragrafi (3) i këtij neni dorëzohet te selia, filiali respektivisht te përfaqësia e personit juridik të huaj.

## **Viktima dhe përfaqësimi i saj**

### Neni 78

(1) Viktima ka të drejtë të marrë pjesë në procedurën kundërvajtëse si e dëmtuar me bashkëngjitjen e kërkesës për ngritjen e procedurës kundërvajtëse ose kërkesës për realizim të kompensimit të dëmit.

(2) Nëse viktima është fëmijë, respektivisht bie në grupin e kategorive të ndjeshme ka të drejtë të masave të veçanta të mbrojtjes procedurale gjatë dhënies së deklaratës dhe hetimit, të përcaktuara në Ligjin për procedurë penale.

## **Mbrojtësi**

### **Neni 79**

(1) I akuzuari i cili do të pranojë ftesë të rregullt për debat, mund të revokojë autorizimin e mbrojtësit të tij më voni tri ditë para fillimit të seancës.

(2) Mbrojtësi mund ta anulojë autorizimin e të akuzuarit më së voni në afat prej tri ditësh para fillimit të seancës, kurse për atë e njofton gjykatën ose është i detyruar të sigurojë prezencë të mbrojtësit tjetër në seancë.

(3) Nëse mbrojtësi në afatin nga paragrafin (2) i këtij neni, nuk e informon gjykatën se ka anuluar autorizimin ose nuk ka siguruar praninë e mbrojtësi tjetër, gjykata mund t'i shqiptojë gjobë në shumë prej 250 eurosh në kundërvlerë me denarë.

## **Dorëzimi i shkresave personave fizikë**

### **Neni 80**

(1) Shkresat dorëzohen me postë, në mënyrë elektronike, nëpërmjet personit zyrtar të organit publik që e dërcon shkresën, drejtpërdrejt tek ai organ ose nëpërmjet personit juridik me autorizime të veçanta të përcaktuara me ligj.

(2) Kur dorëzimi bëhet me postë, postieri lë njoftim në shtëpinë e të akuzuarit që të marrë letrën në postë, kurse nëse letra kthehet me shenjën "i njoftuar - nuk e ka kërkuar", konsiderohet se dorëzimi është kryer në mënyrë të rregullt.

(3) Dorëzimi mund të kryhet me angazhimin e shërbimi tjetër të posaçëm për dorëzim.

(4) Ftesën për debatin kryesor ose ftesat tjera gjykata mund t'ia kumtojë edhe me gojë personit që gjendet para gjykatës, me shpjegim për pasojat e mosardhjes. Thirrja e bërë në këtë mënyrë do të shënohet në procesverbalin, në të cilin personi i thirrur nënshkruhet, përveç nëse ajo thirrje është shënuar në procesverbalin për debatin kryesor. Konsiderohet se me këtë është kryer dorëzimi i vlefshëm.

## **Dorëzimi i shkresës**

### **Neni 81**

(1) Shkresa i dorëzohet drejtpërdrejt personit të cilit i është dërguar, kurse ai është i detyruar ta pranojë atë. Nëse personi nuk takohet aty ku duhet të kryhet dorëzimi, dorëzuesi do t'ia dorëzojë atë dikujt nga anëtarët të familjes së tij, më të vjetër se 16 vjeç, të cilët janë të detyruar ta marrin shkresën. Nëse ata nuk gjenden në shtëpi, shkresa do t'i dorëzohet portierit, drejtuesit ose fqinjit, nëse ata pajtohen ta pranojnë atë. Nëse dorëzimi kryhet në vendin e punës të personit të cilit duhet t'i dorëzohet shkresa kurse personi nuk është hasur aty, dorëzimi mund të kryhet te personi i autorizuar për pranim të postës që është i detyruar të marrë letrën ose personi që është i punësuar në të njëjtin vend, nëse ai pranon të marrë shkresën. Nëse personi nuk haset në adresën që duhet të kryhet dorëzimi, dorëzuesi do të lë njoftim me shkrim për të marrë letrën që personi informohet të shkojë në ditë dhe orë të caktuar në hapësirë të caktuar të organit kompetent për marrjen e letrës. Nëse personi nuk vepron sipas njoftimit, konsiderohet se dorëzimi është kryer në ditën dhe orën e theksuar në njoftim. Me atë konsiderohet se shkresa është dorëzuar.

(2) Nëse konstatohet se personi të cilit duhet t'i dorëzohet shkresa mungon dhe se personat nga paragrafi (1) i këtij neni për këtë shkak nuk mund t'ia dorëzojnë me kohë, shkresa do të kthehet me shënimin ku gjendet ai që mungon.

(3) Nëse dorëzimi nuk kryhet në pajtim me paragrafin (2) të këtij neni, gjykata që e mban procedurën duhet të nxjerrë shkresën në tabelën e shpalljeve. Pas kalimit të tetë ditëve nga dita e shfaqjes, konsiderohet se dorëzimi është kryer në mënyrë të rregullt.

## **Dorëzimi i shkresave personave juridikë**

### Neni 82

- (1) Dorëzimi i shkresës tek personat juridikë kryhet në mënyrë elektronike.
- (2) Dorëzimi kryhet në mënyrë elektronike në kuti postare elektronike në adresën e kutisë postare elektronike dhe do të konsiderohet se është kryer në ditën e pranimit të shkresës në mënyrë elektronike.
- (3) Sistemi informativ i organit kompetent njëkohësisht me dërgimin e letrës deri te pranuesi i dërgesës në adresën e tij elektronike dërgon edhe njoftim se nga sistemi informatik i organit kompetent është dërguar dokument të cilin poseduesi i adresës duhet ta marrë.
- (4) Posta elektronike nga kutia elektronike duhet të merret më së voni 3 (tri) ditë nga dita e dërgimit të saj.
- (5) Në njoftimin nga paragrafi (3) i këtij neni, pranuesi i dorëzimit paralajmërohet nëse posta elektronike nga kutia elektronike nuk merret në afat prej tri ditëve nga dita e dërgimit të saj, dorëzimi do të konsiderohet i kryer.
- (6) Nëse shkresa e cila dorëzohet në mënyrë elektronike përmban shtojca për të cilat nuk ekziston mundësia teknike për t'u dorëzuar në mënyrë elektronike, gjykata respektivisht organi kundërvajtës në shkresën që e dorëzon do ta njoftojë marrësin se shtojcat duhet t'i marrë drejtpërdrejt nga gjykata ose organi kundërvajtës në afat prej pesë ditësh nga dita e njoftimit dhe nëse në atë afat nuk i merr, konsiderohet se shtojcat janë dorëzuar.
- (7) Kur bëhet dorëzimi i vendimeve tek të cilat nga dita e dorëzimit rrjedh afati, si ditë e dorëzimit konsiderohet dita e pranimit të shkresës në mënyrë elektronike, në pajtim me këtë nen.
- (8) Ftesat dhe shkresat tjera, si dhe vendimet dorëzohen në adresë të kutisë postare elektronike e cila është regjistruar para organi kompetent. Nëse gjatë procedurës kundërvajtëse personi juridik e ka ndërruar adresën e kutisë postare elektronike, është i detyruar më së voni në afat prej tri ditësh nga dita e ndryshim të njoftojë organin kompetent për adresën e re elektronike, në të kundërtën do të konsiderohet i rregullt çdo dorëzim i kryer në adresën e mëparshme.
- (9) Vendimi me të cilin personit juridik i shqiptohet sanksion kundërvajtës dorëzohet në formë elektronike në pajtim me këtë nen.
- (10) Nëse nuk ekzistojnë kushte për zbatimin e paragrafit (1) të këtij neni, dorëzimi kryhet me postë, nëpërmjet personit juridik me autorizime të veçanta të përcaktuara me ligj, nëpërmjet personit zyrtar të gjykatës ose drejtpërdrejtë në gjykatë.
- (11) Nëse dorëzimi nuk ka sukses, gjykata që e mban procedurën duhet të nxjerrë shkresën në tabelën e shpalljeve. Pas mbarimit të tetë ditëve nga dita e shfaqjes, konsiderohet se dorëzimi është kryer në mënyrë të rregullt.
- (12) Kur dorëzimi kryhet në pajtim me paragrafin (10) të këtij neni, si ditë e dorëzimit konsiderohet dita e dorëzimit të shkresës në sekretari.

### Kreu i njëmbëdhjetë

## **MBAJTJA E PROCEDURËS KUNDËRVAJTËSE**

### **Kërkesa për ngritje të procedurës kundërvajtëse**

### Neni 83

- (1) Procedura kundërvajtëse ngritet me kërkesë të organit të autorizuar.
- (2) Organet e autorizuar për paraqitjen e kërkesës për fillimin e procedurës kundërvajtëse janë: organet e administratës shtetërore, njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe organet tjera dhe organizatat që kryejnë autorizime publike në kompetencë të të cilave bie ekzekutimi i drejtpërdrejtë ose mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve në të cilat janë paraparë kundërvajtjet.

(3) Organi i autorizuar sipas detyrës zyrtare është edhe prokurori publik në rastet kur kjo është e domosdoshme për mbrojtjen e interesit publik.

(4) Organet e autorizuar nga paragrafi (2) i këtij neni janë të detyruar në afat prej 30 ditëve nga dita e konstatimit të kundërvajtjes ose pas paraqitjes së kallëzimit nga i dëmtuari për kundërvajtje të kryer të paraqesin kërkesë për fillimin e procedurës kundërvajtëse, çdoherë kur ekziston dyshim i bazuar se është kryer kundërvajtje.

(5) Nëse afati nga paragrafi (4) ka kaluar ose nëse është marrë njoftimi se kërkesa është e pabazë, i dëmtuari ka të drejtë të parashtrijë kundërshtim te organi më i lartë kompetent për kryerjen e mbikëqyrjes në punën e organit nga paragrafi (2) i këtij neni, vendimi i të cilit është përfundimtar.

(6) I dëmtuari, nëse ka kërkesë pronësore juridike të njëjtën mund ta realizojë në procedurë kontestimore.

(7) Kërkesa për ngritjen e procedurës kundërvajtëse paraqitet me shkrim ose në mënyrë elektronike të përcaktuar me ligj, në numër të mjaftueshëm kopjesh për organin kompetent dhe personat kundër të cilëve është ngritur procedura kundërvajtëse.

### **Përmbajtja e kërkesës**

#### **Neni 84**

(1) Kërkesa për ngritjen e procedurës kundërvajtëse përmban:

- të dhënat themelore për identitetin e kryerësit (emri, mbiemri, pseudonimi, NUAQ, vendi dhe data e lindjes, vendbanimi, rruga dhe numri, adresa e qëndrimit të përkohshëm, profesioni, shtetësia, nëse personi fizik është i huaj, atëherë në vend të numrit NUAQ-së numri i dokumentit të udhëtimit, kurse për personin juridik emri dhe selia e personit juridik, NUT, kurse për personin përgjegjës në personin juridik edhe funksioni që kryen në atë person juridik,

- përshkrimin faktik të kundërvajtjes nga e cila dalin karakteristikat ligjore të kundërvajtjes, koha dhe vendi i kryerjes së kundërvajtjes dhe rrethanat e tjera të nevojshme që nga afër të përcaktohet kundërvajtja,

- kualifikimin juridik të kundërvajtjes që duhet të zbatohet,

- dëshmitë të cilat duhet të nxirren dhe

- nënshkrimin e parashtruesit të kërkesës.

(2) Me kërkesën dorëzohen dëshmitë.

(3) Kur nuk është e mundur të përcaktohet identiteti i kryerësit të kundërvajtjes në kërkesë, në vend të të dhënave personale duhet të përcaktohet përshkrimi i personit dhe fotografia respektivisht regjistrimi dhe të gjitha të dhënat e tjera për përcaktimin e identitetit të personit. Kjo mund të mbahet në qendër pranimi derisa të përcaktohet identiteti, por më së shumti deri në marrjen e vendimit për kundërvajtje.

(4) Kërkesa për fillimin e procedurës kundërvajtëse në rastet kur ka sende të konfiskuara ose përfitim pronësor të kryera nga kundërvajtje mund të paraqiten edhe kundër kryerësi të panjohur.

### **Kundërvajtja për të cilën gjykata do të kuptojë për kohëzgjatjen e procedurës**

#### **Neni 85**

Nëse gjykata gjatë procedurës kupton për kundërvajtje për të cilën nuk është paraqitur kërkesa nga organi i autorizuar, për këtë do ta informojë organin e autorizuar.

### **Plotësimi i kërkesës**

#### **Neni 86**

(1) Nëse kërkesa për ngritjen e procedurës kundërvajtëse nuk i përmban të gjitha të dhënat nga neni 84 i këtij ligji, do të kërkohej nga parashtruesi i kërkesës ta plotësojë në afatit i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 15 ditë nga dita e marrjes së kërkesës.

(2) Në rast se parashtruesi i kërkesës nuk i largon mangësitë në afatin nga paragrafi (1) i këtij neni, do të konsiderohet se e ka tërhequr kërkesën dhe kërkesa do të refuzohet.

### **Refuzimi i kërkesës**

#### **Neni 87**

(1) Nëse gjykata konstaton se nuk ekzistojnë kushte për ngritjen e procedurës kundërvajtëse, kërkesa do të hidhet poshtë me aktvendim.

(2) Nuk ka kushte për ngritjen e procedurës kundërvajtëse kur:

- veprimi i përshkruar në kërkesë nuk është kundërvajtje,
- ekzistojnë baza që e përjashtojnë përgjegjësinë për kundërvajtje,
- ka ndodhur parashkrim për ngritjen e procedurës kundërvajtëse,
- kërkesën e ka parashtruar parashtruesi, respektivisht personi i paautorizuar,
- ekzistojnë arsye tjera ligjore për të cilat procedura kundërvajtëse nuk mund të ngrihet,
- kërkesa nuk është shoqëruar me dëshmi për kundërvajtje të kryer dhe
- kërkesa nuk i përmban të dhënat e nevojshme nga neni 84 i këtij ligji.

(3) Aktvendimi nga paragrafi (1) i këtij neni i dorëzohet parashtruesit të kërkesës.

(4) Kundër aktvendimit nga paragrafi (1) i këtij neni parashtruesi i kërkesës ka të drejtë ankese në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit të gjykata e shkallës së dytë.

(5) Aktvendimi nga paragrafi (1) i këtij neni nuk është pengesë për mbajtjen e procedurës së veçantë për marrjen e sendeve ose konfiskimin e përfitimit pronësor.

### **Bashkimi dhe ndarja e procedurës**

#### **Neni 88**

(1) Nëse i akuzuari me një veprim ose disa veprime ka kryer më shumë kundërvajtje për të cilat nuk është marrë vendim kurse për të gjitha vendimet është kompetente gjykata e njëjtë, sipas rregullit, do të zbatohet një procedurë e vetme dhe do të merret një vendim i vetëm për kundërvajtjen. Procedura e vetme, sipas rregullit, do të zbatohet kundër personi juridik dhe personit përgjegjës, kundër të akuzuarit, bashkëpunëtorit, nxitësit dhe ndihmësit, përveç nëse ekzistojnë kushte ligjore që procedura të mbahet vetëm kundër njërit prej tyre.

(2) Deri në miratimin e vendimit për kundërvajtje për shkaqe të arsyeshme ose për shkak të rezultatit, gjykata mund të vendosë që procedura për kundërvajtje të veçanta ose kundër të të akuzuarve të veçantë, bashkëpunëtorëve nxitësve ose ndihmësve të ndahet nga procedura e vetme dhe të mbarojë individualisht.

(3) Për bashkimin dhe ndarjen e procedurës gjykata do miratojë vendim kundër të cilit nuk lejohet ankimi.

### **Ngritja e procedurës kundërvajtëse**

#### **Neni 89**

(1) Nëse gjykata nuk e miraton aktvendimin për refuzimin e kërkesës, gjykata është e obliguar të caktojë seancë dhe ta njoftojë të akuzuarin.

(2) Gjukata së bashku me ftesën për hetim do t'i dorëzojë të akuzuarit kërkesën për ngritjen e procedurës kundërvajtëse së bashku me dëshmitë me shkrim.

## Kreu i dymbëdhjetë

### MASA PËR SIGURIMIN E PREZENCËS SË TË AKUZUARIT

#### Llojet e masave

##### Neni 90

Masat që mund të ndërmerren kundër të akuzuarit për të siguruar praninë dhe mbajtjen e procedurës kundërvajtëse janë: ftesa, arrestimi, Mbajtja, garancia dhe marrja e përkohshme e dokumentit të udhëtimit të të huajit dhe mbajtja e të huajit në qendër pranimit.

#### Ftesa

##### Neni 91

(1) Prania e të të akuzuarit gjatë seancës në procedurën kundërvajtëse do të sigurohet me ftesë. Ftesën e dërgon gjykata që e mban procedurën kundërvajtëse.

(2) I akuzuari me ftesë informohet për çka është i akuzuar dhe është i detyruar të paraqitet personalisht ose mbrojtjen ta japë me shkrim. I akuzuari i cili është i ftuar të vijë personalisht në paralajmërim duhet të paralajmërohet se do të paraburgoset nëse ai nuk i përgjigjet ftesës. Nëse për vendimmarrje të drejtë nuk është e nevojshme që të merret në pyetje ai do të paralajmërohet se vendimi për kundërvajtjen do të merret pa dëgjim, nëse nuk i përgjigjet ftesës.

(3) Së bashku me ftesën do të dorëzohet kopje e kërkesës për ngritjen e procedurës kundërvajtëse.

#### Arrestimi

##### Neni 92

(1) Nëse i akuzuari i thirrur në mënyrë të rregullt nuk i paraqitet ftesës dhe nuk e justifikon mungesën e tij, ose nëse nuk ka qenë e mundur që thirrja t'i dorëzohet në mënyrë të rregullt, kurse nga rrethanat është e qartë se i akuzuari shmanget, kurse prania e tij është e nevojshme për vendimmarrjen e drejtë do të caktohet arrestim. Arrestimi është i mundshëm të caktohet vetëm në rastet kur në ftesë është këshilluar që i akuzuari është i detyruar të paraqitet personalisht.

(2) Arrestimi caktohet me shkrim. Në urdhër duhet të theksohet emri dhe mbiemri i të akuzuarit që duhet të arrestohet, numri unik amë, datëlindja, vendqëndrimi i të akuzuarit, lënda në të cilën përcaktohet paraburgimi dhe arsyeja për të cilën është caktuar arresti.

(3) Urdhri duhet të ketë vulë dhe nënshkrim të gjykatësit që e ka caktuar arrestimin.

#### Garancia

##### Neni 93

(1) Kur fillohet procedura kundërvajtëse kundër të akuzuarit i cili nuk jeton në Republikën e Maqedonisë kurse dëshiron të largohet para përfundimit të procedurës, gjykata, me kërkesën e tij, mund ta lejojë të depozitojë garanci si siguri për përmbushjen e detyrimeve që mund të përcaktohen në vendimin për kundërvajtje.

(2) Gjkata mund të kërkojë nga i akuzuari, krahas dhënies së garancisë, të përcaktojë të autorizuar që në emër të tij do të marrë shkresat dhe do ta përfaqësojë në procedurë, nëse janë në pyetje të drejtat e tij pronësore.

(3) Garancia nuk mund të përcaktohet para se i akuzuari të dëgjohet.

(4) Garancia gjithmonë përbën shumë me para të përcaktuar sipas peshës së kundërvajtjes, lartësisë së dëmit të shkaktuar, rrethanave personale dhe familjare të të akuzuarit dhe statusit të pronës së personit që e jep atë.

(5) Garancia konsiston në vendosjen e parave të gatshme, letrave me vlerë, sendeve të vlefshme ose sendeve të tjera të luajtshme me vlerë më të madhe që mund të shndërrohen në para ose të ruhen.

(6) Nëse procedura me vendim është ndërprerë, garancia e ofruar do të kthehet.

(7) Nëse kryesi i kundërvajtjes pas vendimit të plotfuqishëm për kundërvajtjen nuk e paguan gjobën e shqiptuar, ose nuk e kompenson dëmin e shkaktuar, përfitimin e fituar të pronës dhe shpenzimet e procedurës, nga garancia e ofruar do të paguhet: gjoba, dëmi i përcaktuar, dobia e fituar pronësore dhe shpenzimet e procedurës, dhe shuma e tepërt do të kthehet.

(8) Për dhënien e garancisë dhe kthimin e saj gjykata do të miratojë vendim të veçantë.

## **Mbajtja**

### **Neni 94**

(1) Nëse ekziston dyshimi i bazuar se i akuzuari ka kryer kundërvajtje, gjykata mund të urdhërojë mbajtjen nëse nuk është e mundur të përcaktohet identiteti i tij ose nëse nuk ka vendqëndrim në Republikën e Maqedonisë, kurse ekziston dyshimi i arsyeshëm për përsëritjen e kundërvajtjes ose se do të largohet ose nëse largohet me qëllim të qëndrimit jashtë shtetit mund të shmangë përgjegjësinë për kundërvajtjen.

(2) I akuzuari i cili është mbajtur ka të drejtë menjëherë të informohet në gjuhën e tij amtare ose në gjuhën që ai e kupton për arsyet e mbajtjes, si dhe të jetë i udhëzuar se nuk është i detyruar të deklarojë asgjë, se ai ka të drejtë për ndihmë momentale juridike të mbrojtësi të cilin mund ta zgjedhë në mënyrë të pavarur dhe se organi kompetent sipas kërkesës së tij është i detyruar t'i njoftojë të afërmit e tij respektivisht punëdhënësin për mbajtjen kurse nëse ai është shtetas i huaj, me kërkesën e tij dhe me përfaqësi diplomatike të shtetit të tij.

(3) Të akuzuarit menjëherë, kurse më së voni për gjashtë orë nga momenti i mbajtjes, duhet t'i jepet vendim me shkrim i lëshuar nga gjykata kompetente për arsyet e mbajtjes nga liria me këshillë juridike dhe theksohet vendi ku personi do të mbahet.

(4) Derisa zgjat mbajtja i të akuzuarit ka të drejtë të ankesës kundër aktvendimit. Ankesa nuk e prolongon aktvendimin për mbajtje.

(5) Pas ankesës për ligjshmërinë e mbajtjes vendos këshilli penal pranë gjykatës themelore në afat prej 24 orëve nga marrja e ankesës.

(6) Mbajtja mund të zgjasë më së shumti 12 orë nga ora kur kryerësi është mbajtur, gjatë së cilës dëgjohet dhe sillet vendim për kundërvajtje ose lëshohet në liri.

(7) Për mbajtjen e të akuzuarit në mënyrë adekuate zbatohen dispozitat e Ligjit për procedurë penale për ekzekutimin e paraburgimit, nëse me këtë ligj nuk është paraparë ndryshe.

## **Mbajtja e të huajit në qendër pranimit**

### **Neni 95**

(1) Nëse kryerësi i kundërvajtjes është i huaj, identiteti i të cilit nuk mund të përcaktohet, gjykata menjëherë përcakton masën e mbajtjes në qendrën e pranimit.

(2) Me aktvendim, mbajtja e të huajit mund të zgjasë deri në 30 ditë nga dita e nmbajtjes dhe gjykata mund ta vazhdojë edhe për 30 ditë.



(3) Kundër aktvendimit i huaji ka të drejtë ankese në gjykatën e shkallës së dytë në afat prej 48 orëve nga momenti i mbajtjes në qendrën e pranimit. Ankesa nuk e prolongon përmbarimin e aktvendimit.

(4) Kur gjykata do të caktojë mbajtjen e të huajit në qendrën për strehim, e njofton Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe e obligon që të marrë masa për përcaktimin e identitetit të të huajit.

(5) Gjykata miraton aktvendim për ndërprerjen e mbajtjes menjëherë pas marrjes së të dhënave për identitetit e të huajit.

(6) Vendosja në qendrën për strehim rregullohet me ligj te veçantë.

### **Mbajtja e personave nën ndikim të alkoolit ose të substancave tjera narkotike**

#### **Neni 96**

(1) Ministria e Punëve të Brendshme mund të urdhërojë mbajtjen e kryerësit i cili nën ndikimin e alkoolit ose të substancave të tjera narkotike është hasur gjatë kryerjes së kundërvajtjes, nëse ekziston rreziku se do të vazhdojë të kryejë kundërvajtje në të ardhmen kurse nuk ekzistojnë kushte që menjëherë ta transferojë në institucion shëndetësor. Mbajtja mund të zgjatë më së shumti 12 orë nga momenti i mbajtjes. Shpenzimet për qëndrim bien në barë të kryerësit të kundërvajtjes.

(2) Për secilën mbajtje, Ministria e Punëve të Brendshme përpilon procesverbal në të cilin vendosen masat e marra dhe nëse merren masa mjekësore edhe masat mjekësore. Ekzemplar nga procesverbali i dorëzohet personit të mbajtur.

(3) Person nën ndikimin e alkoolit ose substancave të tjera narkotike konsiderohet personi për të cilin kjo është përcaktuar në pajtim me ligjin, duke përdorur mjete dhe pajisje teknike ose nëse nga paraqitja, sjellja, gjendja psikofizike dhe rrethanat e tjera ai nuk është në gjendje të menaxhojë veprimet e tij.

### **Arrestimi i personave të hasur gjatë kryerjes së kundërvajtjes**

#### **Neni 97**

(1) Ministria e Punëve të Brendshme edhe pa urdhër të gjykatës mund ta arrestojnë personin e kapur gjatë kryerjes së kundërvajtjes, nëse nuk është e mundur të përcaktohet identiteti i kryerësit ose nëse ai nuk ka vendqëndrim ose nëse me largimin jashtë vendit për qëndrim do mund të shmangë përgjegjësinë për kundërvajtjen, ose nëse ka rrethana që bëjnë vlerësimin se kryerësi do të vazhdojë me kundërvajtjen ose se do ta përsërisë atë.

(2) Nëse në rastin nga paragrafi (1) i këtij neni, kryerësi është kapur gjatë kryerjes së kundërvajtjes në kohën kur gjykata nuk punon ose nëse ekzistojnë rrethana të cilat tregojnë rrezikun se ai do të ikë ose do të vazhdojë me kundërvajtje ose do ta përsërisë atë, mund ta mbajë nëpunësi policor. Mbajtja zgjat deri sa të mos jetë e mundur që kryesi të nxirret para gjykatës kompetente, por jo më gjatë se 12 orë.

(3) Kryerësi i cili është arrestuar menjëherë duhet të informohet në gjuhën e tij amtare ose në gjuhën që e kupton për shkaqet e arrestimit, si dhe të këshillohet se nuk është i detyruar të deklarojë asgjë, se ka të drejtë për ndihmë momentale juridike të mbrojtësit të cilin mund ta zgjedhë në mënyrë të pavarur dhe se organi kompetent sipas kërkesës së tij është i detyruar t'i njoftojë të afërmit e tij.

## **Njoftimi për mbajtje për shkak të arrestimit**

### Neni 98

(1) Gjykata, përkatësisht Ministria e Punëve të Brendshme, e cila ka caktuar mbajtjen, me kërkesë të personit të mbajtur është i detyruar ta njoftojë familjen e tij për mbajtjen. Me kërkesën e personit të mbajtur për mbajtjen do të njoftohet edhe punëdhënësi i tij, respektivisht përfaqësia diplomatike e shtetit të huaj, nëse është e nevojshme të marrë diçka për mbrojtjen ose kujdesin e fëmijëve dhe të anëtarëve të tjerë të familjes, për të cilët kujdeset personi i mbajtur, si dhe qendra kompetente për punë sociale.

(2) Për mbajtjen e personit nga personeli ushtarak sipas detyrës zyrtare do të informohet njësisia ushtarake, respektivisht komanda të cilës eprori ushtarak i takon.

### Kreu i trembëdhjetë

## **DËSHMIMI**

### **Pranimi i kundërvajtjes**

### Neni 99

Nëse i akuzuari e pranon kryerjen e kundërvajtjes dhe pranimi është vullnetar, me vetëdije, në mënyrë të qartë dhe i tërësishëm, gjykata nuk ka nevojë të grumbullojë edhe dëshmi të tjera.

### **Dëgjimi i dëshmitarëve**

### Neni 100

(1) Dëshmitari do të dëgjohej para gjykatës para të cilës mbahet procedura kundërvajtëse.

(2) Nëse dëshmitari ka vendbanim ose vendqëndrim jashtë selisë së gjykatës, dëgjimi i dëshmitarit do të kryhet në rrugë të kërkuar deri te gjykata sipas vendbanimit ose vendqëndrimit të dëshmitarit.

### Kreu i katërbëdhjetë

## **NDËRPRERJA DHE NDALIMI I PROCEDURËS KUNDËRVAJTËSE PARA GJYKATËS**

### **Ndërprerja e procedurës**

### Neni 101

(1) Gjykata që e mban procedurën kundërvajtëse me aktvendim do ta ndërpresë procedurën nëse:

- nuk mund të vërtetohet vendbanimi respektivisht vendqëndrimi i të akuzuarit dhe nëse për ndonjë arsye tjetër, nuk është në dispozicion të organeve publike ose gjendet jashtë vendit për kohë të pacaktuar,

- te i akuzuari ka ndodhur sëmundje e përkohshme shpirtërore ose shqetësim i përkohshëm shpirtëror,

- për të njëjtën vepër është ngritur procedurë penale deri në përfundimin e procedurës penale dhe

- procedura që është ndërprerë në bazë të alinesë 3 të këtij neni do të vazhdojë kur procedura penale është ndërprerë në bazë tjetër kurse edhe më tej ekzistojnë kushtet për kryerjen e procedurës kundërvajtëse.

(2) Para miratimit të aktvendimit për ndërprerjen e procedurës kundërvajtëse do të grumbullohen të gjitha dëshmitë për kundërvajtje dhe përgjegjësinë e të akuzuarit te të cilat mund të vihet.

(3) Procedura e ndërprerë do të vazhdojë kur do të pushojnë shkaqet për të.

(4) Për ndërprerjen dhe vazhdimin e procedurës do të njoftohet parashtruesi i kërkesës.

(5) Aktvendimi nga paragrafi (1) i këtij neni nuk përmban këshillë juridike.

### **Ndërprerja e pjesshme e procedurës kundërvajtëse**

#### **Neni 102**

(1) Nëse gjoba paguhet dhe nëse urdhërpagesa kryhet në afatet e përcaktuara me këtë ligj, gjykata do të miratojë aktvendim me të cilin procedura ndërpritet në atë pjesë dhe do të mbahet procedurë pas kërkesës së paraqitur për shqiptimin e sanksioneve kundërvajtëse nga neni 23 paragrafët (5), (6), (7), (8) dhe (9) të këtij ligji, si sanksione kundërvajtëse të pavarura për kundërvajtje të kryer.

(2) Kundër aktvendimit nga paragrafi (1) i këtij neni lejohet ankesë.

(3) Kur procedura është e ndërprerë me aktvendim, shpenzimet bien në barë të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë.

### **Procedura për marrje me vendim të gjykatës**

#### **Neni 103**

(1) Sendet që mund të konfiskohen sipas nenit 40 të këtij ligji përkohësisht mund të konfiskohen edhe para marrjes së vendimit për kundërvajtjen për të cilën lëshohet vërtetim.

(2) Gjatë mbajtjes së procedurës kundërvajtëse, gjykata, me urdhër me shkrim, përkohësisht mund të konfiskojë send. Kopja e urdhrut duhet t'i dorëzohet organit të ngarkuar me ruajtjen e sendeve të konfiskuara, si dhe personit nga i cili janë konfiskuar sendet.

(3) Nëse sendi është nga ato që prishen lehtë ose nëse ruajtja kërkon shpenzime joproporcionale, gjykata përgjegjëse për mbajtjen e procedurës kundërvajtëse e dorëzon të Agjencinë për Menaxhim me Pronën e Konfiskuar e cila vepron në pajtim me ligjin.

#### **Kreu i pesëmbëdhjetë**

### **RRJEDHA E PROCEDURËS**

#### **Procedura e shkurtuar**

#### **Neni 104**

(1) Procedura e shkurtuar mbahet kur:

- në kërkesën për fillimin e procedurës kundërvajtëse përmbahen të gjitha faktet dhe dëshmitë në bazë të të cilave gjykata mund të vendosë pa praninë e palës,

- kërkesa për ngritjen e procedurës bazohet në dokumentet publike të lëshuara nga organi kompetent publik dhe

- kryerësi është kapur gjatë kryerjes së kundërvajtjes nga personi i autorizuar zyrtar.

(2) Gjkata vendos në procedurë të shkurtuar pa e marrë në pyetje kryerësin kur ai është i thirrur në mënyrë të rregullt, kurse nuk paraqitet dhe nuk paraqet dëshmi për pengesë të arsyeshme të paraqitet para gjykatës.

## **I akuzuari dhe e drejta e tij e mbrojtjes**

### **Neni 105**

Nëse i akuzuari paraqitet për marrje në pyetje për shkak të kontrollit të pretendimeve në kërkesën e paraqitur për ngritjen procedurës kundërvajtëse, gjykata mund të ftojë me procesverbal të dëgjohen dëshmitarët ose ekspertët.

### **Gjykatësi kujdestar**

### **Neni 106**

(1) Për shkak të shpejtësisë së procedurës gjykata siguron punë të vazhdueshme gjatë 24 orëve.

(2) Me orarin e punës së gjykatës përcaktohet gjykatës kujdestar dhe punëtor gjyqësor gjatë gjithë ditës, ditë jo pune dhe ditë feste.

### **Urgjenca e procedurës kundërvajtëse**

### **Neni 107**

(1) Gjykata është e detyruar të fillojë procedurë kundërvajtëse menjëherë pas marrjes së kërkesës për fillimin e procedurës kundërvajtëse kurse më së voni në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të kërkesës.

(2) Procedura para gjykatës së shkallës së parë duhet të përfundojë në afat prej tre muajve nga dita e paraqitjes së kërkesës për ngritje të procedurës kundërvajtëse.

(3) Kur i akuzuari është i huaj, gjykata vendos me procedurë urgjente në afat sa më të shkurtë të mundshëm por jo më gjatë se tri ditë nga dita e pranimit të kërkesës për fillimin e procedurës kundërvajtëse.

(4) Ankesa e shprehur nga i huaji nuk e prolongon përmbarimin vendimit.

### **Shqyrtimi me gojë**

### **Neni 108**

(1) Gjykata që mban procedurë kundërvajtëse cakton shqyrtim me gojë, nëse ajo është e nevojshme për sqarimin e gjendjes faktik

(2) Në shqyrtim thirren parashtruesi i kërkesës për ngritjen e procedurës kundërvajtëse, i akuzuari, mbrojtësi i tij dhe dëshmitari, kurse sipas nevojës personi që e konstaton, i dëmtuari ose eksperti. Nëse i akuzuari është person juridik në shqyrtim thirret përfaqësuesi i tij.

### **Shqyrtimi me gojë në mungesë të të akuzuarit**

### **Neni 109**

(1) Gjykata e cila e mban procedurën mund të vendos të mbahet shqyrtim me gojë në mungesë të të akuzuarit i cili është ftuar në mënyrë të rregullt, nëse gjykata përcakton se prania e tij nuk është e rëndësishme për përcaktim të rregullt të gjendjes faktike. Me kushtet të njëjta mund të mbahet shqyrtim edhe në mungesë të përfaqësuesit të ftuar në mënyrë të rregullt të personit të akuzuar juridik.

(2) Shqyrtimi do të mbahet kur nuk do të vijë përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës i ftuar në mënyrë të rregullt, nëse prania e tij nuk është e domosdoshme për shtjellim të gjendjes faktike.

(3) Shqyrtimi do të mbahet edhe kur nuk do të vijë mbrojtësi i të akuzuarit i ftuar në mënyrë të rregullt.

## **Rrjedha e shqyrtimit me gojë**

### Neni 110

(1) Shqyrtimi fillon me shpalljen e përmbajtjes kryesore të kërkesës. Mandej fillon marrja në pyetje e të akuzuarit. Nëse janë të akuzuar person juridik dhe person përgjegjës i personit juridik, së pari dëgjohet përfaqësuesi i personit juridik, ndërsa pas tij personi përgjegjës. Pas marrjes në pyetje të të akuzuarit zbatohet procedurë e dëshmisë me dëgjim të dëshmitarëve, ekspertë dhe nxjerrje të dëshmimeve të tjera.

(2) Parashtruesi i kërkesës, i akuzuari dhe mbrojtësi i tij dhe përfaqësuesi i personit juridik kanë të drejtë që gjatë shqyrtimit të propozojnë dëshmi dhe të vënë propozime të tjera, ndërsa pas lejes së gjykatësit i cili e udhëheq procedurën e kundërvajtjes mund t'u parashtojnë pyetje personave të cilët dëgjohen.

(3) Në shqyrtim fjalën e fundit kurdoherë e ka i akuzuari, përkatësisht përfaqësuesi i personit të akuzuar juridik.

(4) Nëse gjykatësi i cili e udhëheq procedurën e kundërvajtjes gjen se dëgjimi nuk duhet të prolongohet për shkak të plotësimit të procedurës ose shpjegimit të çështjeve të caktuara, do ta përfundojë shqyrtimin dhe do të miratojë vendimin për kundërvajtjen, dhe publikisht do ta shpall shqiptimin e vendimit me shpjegim të shkurtër të shkaqeve.

(5) Për punën e shqyrtimit mbahet procesverbal në të cilin futet në pika të rëndësishme, e gjithë rrjedha e shqyrtimit. Procesverbalin e nënshkruan gjykatësi dhe procesverbalmajtësi.

## **Veprimi në rast kur i akuzuari ka kryer kundërvajtje gjatë procedurës**

### Neni 111

(1) Nëse gjatë nxjerrjes së veprimeve në procedurën kundërvajtëse i akuzuari ka kryer kundërvajtje të re ose zbulohet kundërvajtje e kryer më herët, gjykata e cila e mban procedurën e kundërvajtjes, sipas rregullës, me kërkesë të parashtruesit të pranishëm të kërkesës, do ta zgjerojë procedurën edhe për atë kundërvajtje,

(2) Nëse parashtruesi i kërkesës nuk është i pranishëm ose nuk është i autorizuar për parashtrim të kërkesës për ngritje të procedurës së kundërvajtjes dhe në pikëpamje të kundërvajtjes nga paragrafi (1) i këtij neni ose i akuzuari ka bërë vepër penale, gjykatësi për atë do ta përpilojë procesverbalin dhe me të do ta njoftojë parashtruesin kompetent të kërkesës, përkatësisht prokurorin publik. Në mënyrë të njëjtë do të veprohet nëse edhe ndonjë tjetër gjatë nxjerrjes së veprimeve në procedurën e kundërvajtjes ka kryer kundërvajtje.

## **Miratimi dhe shpallja e vendimeve**

### Neni 112

(1) Procedura e kundërvajtjes përfundon me miratimin e aktgjykimit ose aktvendimit.

(2) Aktgjykimi ose aktvendimi për kundërvajtje miratohet vetëm për person për të cilin kërkohet ngritje e procedurës për kundërvajtje dhe vetëm për kundërvajtje që është lëndë e kërkesës.

(3) Gjukata nuk është e lidhur për propozimet dhe vlerësimin në lidhje me kualifikimin juridik të kundërvajtjes.

(4) Aktgjykimi ose aktvendimi për kundërvajtjen bazohet në dëshmitë e nxjerra dhe faktet e përcaktuara në procedurën e kundërvajtjes.

## **Aktgjykimi**

### **Neni 113**

(1) Me aktgjykim për kundërvajtje i akuzuari shpallet fajtor dhe i shqiptohet sanksion i kundërvajtjes ose lirohet nga përgjegjësia.

(2) Nëse procedura e kundërvajtjes mbahet për më shumë kundërvajtje, në aktgjykim do të ceket për cilat kundërvajtje shpallet fajtor dhe cili sanksion kundërvajtës i shqiptohet, përkatësisht lirohet nga përgjegjësia.

(3) Aktgjykimi me shkrim për kundërvajtje doemos duhet të ketë hyrje, diapozitiv dhe arsyetim.

(4) Hyrja e aktgjykimit për kundërvajtje e përmban emrin e gjykatës që e ka miratuar, emrin dhe mbiemrin e gjykatësit i cili e ka miratuar aktgjykimin, emrin dhe mbiemrin e të akuzuarit dhe mbrojtësit, firmën, përkatësisht titullin dhe selinë e personit të akuzuar juridik dhe kundërvajtjen që është lëndë e procedurës.

(5) Diapozitivi i aktgjykimit për kundërvajtje doemos duhet t'i përmbajë të dhënat personale të të akuzuarit, të dhëna për personin e akuzuar juridik, se i akuzuari është përgjegjës për kundërvajtje ose sanksion kundërvajtës që shqiptohet ose i akuzuari lirohet nga përgjegjësia.

(6) Kur aktgjykimi për kundërvajtje ka arsyetim, gjykata do t'i cekë dëshmitë dhe rrethanat në bazë të të cilave e bazon vendimin e vet.

(7) Aktgjykimi i miratuar në procedurë të shkurtuar, si dhe aktgjykimi me të cilin e pranon kundërvajtjen dhe kur heq dorë nga e drejta e ankesës, nuk ka arsyetim.

(8) Aktgjykimi përmban këshillë juridike.

### **Aktgjykimi me të cilin i akuzuari lirohet**

### **Neni 114**

Aktgjykim me të cilin i akuzuari lirohet nga përgjegjësia do të miratohet, nëse:

- 1) veprimi nuk është kundërvajtje;
- 2) i akuzuari nuk e ka kryer kundërvajtjen;
- 3) ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë për kundërvajtje;
- 4) procedura është mbajtur pa kërkesë të organit të autorizuar (neni 83 paragrafi (1) të këtij ligji);
- 5) procedura është mbajtur nga gjykatë jokompetente reale;
- 6) i akuzuari për kundërvajtje të njëjtë në mënyrë të plotfuqishme është sanksionuar në procedurë të kundërvajtjes, ose procedura e kundërvajtjes në mënyrë të plotfuqishme është ndërprerë, po jo për shkak të jokompetencës;
- 7) i akuzuari në procedurë penale në mënyrë të plotfuqishme është shpallur fajtor për veprë e cila i përfshin edhe shenjat e kundërvajtjes;
- 8) i akuzuari gëzon imunitet diplomatik;
- 9) është paraqitur vjetërsim për mbajtje të procedurës së kundërvajtjes;
- 10) nuk ka dëshmi se i akuzuari e ka kryer kundërvajtjen dhe
- 11) parashtruesi i kërkesës ka hequr dorë nga kërkesa para plotfuqishmërisë së aktgjykimit për kundërvajtje.

### **Aktvendimi për ndërprerje të procedurës së kundërvajtjes**

### **Neni 115**

(1) Procedura e kundërvajtjes ndërpritet me aktvendim, nëse:

- i akuzuari ka vdekur,

- personi juridik ka pushuar të ekzistojë,
- gjykata përcakton se kundërvajtja është kryer në gjendje të paparamenduar dhe
- gjatë rrjedhës së procedurës te personi i akuzuar është krijuar sëmundje e përhershme mendore dhe në raste të tjera të caktuara me këtë ligj.

(2) Procedura e kundërvajtjes do të ndërpritet edhe në raste të tjera të përcaktuara me ligj.

### **Aktgjykimi me të cilin i akuzuari shpallet fajtor**

#### Neni 116

(1) Në aktgjykimin për kundërvajtje me të cilin i akuzuari do të shpallet fajtor, do të theksohet:

- për cilën kundërvajtje, përkatësisht cilat kundërvajtje të akuzuarit i shqiptohet sanksion kundërvajtës, përshkrim i kundërvajtjes dhe kualifikim juridik për kundërvajtjen,
- sanksioni i kundërvajtjes që i shqiptohet të akuzuarit, përkatësisht vendimi për lirim nga sanksioni,
- sanksione të kundërvajtjes për kundërvajtje të veçanta dhe sanksion i vetëm i kundërvajtjes, nëse bëhet fjalë për përfundim të kundërvajtjeve,
- vendimi për konfiskim të pronës dhe dobi pronësore dhe konfiskim të sendeve,
- vendimi për llogaritje të mbajtjes,
- vendimi për shpenzime të procedurës dhe
- vendimi për kërkesë pronësore-juridike.

(2) Në aktgjykimin për kundërvajtje do të përcaktohet afati në të cilin duhet të paguhet gjoba dhe theksohet paralajmërimi për pagesë të detyrueshme.

### **Shpenzime të procedurës**

#### Neni 117

(1) Shpenzime për procedurën e kundërvajtjes janë:

- shtesa për dëshmitarë, ekspertë, përkthyes, interpretues dhe persona të tjerë të nevojshëm në procedurë, kontroll dhe ruajtje të sendeve të konfiskuara,
- shtesa për arrestim,
- shpenzime për veprime zyrtare edhe për persona të autorizuar zyrtarë,
- shtesa për shërim të të akuzuarit, për kohën kur është i mbajtur,
- shpenzime të rrugës të të akuzuarit,
- paushall,
- shpërblimi dhe shtesa të nevojshme për mbrojtësin.

(2) Paushalli përcaktohet në kufijt e shumave të përcaktuara në pajtim me kohëzgjatjen dhe ndërlikimin e procedurës dhe në pajtim me gjendjen e përgjithshme të personit që është i obliguar ta paguajë.

(3) Shpenzimet nga paragrafi (1) alinetë 1, 2, 3 dhe 4 të këtij neni në procedurën e kundërvajtjes paguhet para kohe nga mjetet e gjykatës, ndërsa më vonë gjykata i kompenson nga personi i cili sipas nenit 118 të këtij ligji është i obliguar t'i paguajë.

### **Pagesa e shpenzimeve të procedurës së kundërvajtjes**

#### Neni 118

(1) Shpenzimet e procedurës së kundërvajtjes i paguan i gjykuari, të cilit i është shqiptuar sanksioni i kundërvajtjes.

(2) Nëse është mbajtur procedurë e kundërvajtjes për më shumë kundërvajtje, personi të cilit i është shqiptuar sanksion i kundërvajtjes nuk do t'i bartë shpenzimet për kundërvajtjet për të cilat është miratuar aktgjykim i lirimit, nëse ato shpenzime mund të ndahen nga shpenzimet e përgjithshme.

(3) Nëse me vendimin e njëjtë u është shqiptuar sanksion i kundërvajtjes më shumë të akuzuarve, do të përcaktohet çfarë pjese të shpenzimeve paguan secili prej tyre, ndërsa nëse ajo nuk mund të përcaktohet të gjithë të akuzuarit në mënyrë solidare do t'i paguajnë shpenzimet e procedurës.

(4) Shpenzimet e procedurës së kundërvajtjes në cilin do aktgjykim të miratuar të lirimit bien në barë të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë.

(5) Gjykata e cila e mban procedurën e kundërvajtjes mund ta lirojë të akuzuarin të cilit i është shqiptuar sanksion kundërvajtës nga kompensimi i shpenzimeve të procedurës nga neni 117 paragrafi (1) të këtij ligji, dhe shtesat e nevojshme për mbrojtësin, nëse për shkak të pagesës së shpenzimeve i është kërcënuar ekzistenca e tij ose e personave të cilët është i obliguar t'i mbajë.

### **Aktvendimi për shpenzime**

#### **Neni 119**

(1) Në vendimin për kundërvajtje përcaktohet kush i paguan shpenzimet dhe lartësia e tyre.

(2) Nëse për përcaktim të shpenzimeve nuk ka të dhëna të mjaftueshme, për shpenzimet e procedurës do të miratohet aktvendim i veçantë.

(3) Kërkesa me të dhënat për lartësinë e shpenzimeve të procedurës që është ndërprerë ose është miratuar aktgjykim i lirimit mund të parashtrohet në afat prej tre muajsh nga dita e aktgjykimit të plotfuqishëm ose aktvendimi i është dorëzuar atij personi që ka të drejtë të parashtrojë kërkesë të tillë.

### **Shpenzime të veçanta**

#### **Neni 120**

(1) I akuzuari, përfaqësuesi ligjor, përfaqësuesi i personit juridik, mbrojtësi, i autorizuari, dëshmitari, eksperti, përkthyesi, interpretuesi dhe person tjetër i nevojshëm në procedurë pa marrë parasysh rezultatit nga procedura e kundërvajtjes i paguajnë shpenzimet për arrestimin e tyre, prolongimin e veprimit në procedurën e kundërvajtjes dhe shpenzime të tjera të cilat i kanë shkaktuar me fajin e vet.

(2) Për shpenzimet e procedurës nga paragrafi (1) i këtij neni miratohet aktvendim i veçantë.

### **Shpenzime në procedurë për mjete juridike**

#### **Neni 121**

(1) Për pagesë të shpenzimeve në procedurë pas ankese do të vendosë gjykata e shkallës së dytë në pajtim me dispozitat e neneve 117, 118, 119 dhe 120 të këtij ligji.

(2) Paushalli nuk do të përcaktohet, nëse me vendimin e gjykatës së shkallës së dytë është vendosur plotësisht ose pjesërisht në dobi të të akuzuarit.

(3) Paushall do të përcaktohet edhe në rast nëse ankesa është e refuzuar.



## **Shpenzime të procedurës me mjete juridike të jashtëzakonshme**

### **Neni 122**

Për pagesën e shpenzimeve të cilat do të krijohen në procedurën e kundërvajtjes me mjete të jashtëzakonshme juridike në mënyrë adekuate zbatohen dispozitat nga nenet 117, 118, 119 dhe 120 të këtij ligji.

## **Miratimi i rregullave për shpenzime të procedurës**

### **Neni 123**

Lartësinë dhe mënyrën e caktimit të shpenzimeve të bëra reale për procedurën e kundërvajtjes që mbahet para gjykatave i cakton kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë.

Kreu i gjashtëmbëdhjetë

## **MJETE JURIDIKE**

### **Llojet e mjeteve juridike**

#### **Neni 124**

(1) Kundër aktgjykimit dhe aktvendimit të gjykatës së shkallës të parë mund të deklarohet ankesë te gjykata e shkallës së dytë.

(2) Në procedurë të kundërvajtjes të përfunduar me aktgjykim mund të shfrytëzohen meje të jashtëzakonshme juridike: kërkesë për ngritje të procedurës së kundërvajtjes dhe kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë.

### **Procedura për mjete juridike**

#### **Neni 125**

(1) Në procedurën e kundërvajtjes për mjete juridike të rregullta dhe të jashtëzakonshme, mbrojtësi doemos duhet të dorëzojë autorizim, ndërsa nëse mbrojtësi nuk dorëzon autorizim, konsiderohet se mjeti i parashtruar juridik është i parregullt.

(2) Në procedurën për mjete të rregullta dhe për mjete të jashtëzakonshme juridike, pala nuk mund të propozojë dëshmi të reja për të cilat e ka ditur dhe ka mundur t'i propozojë në procedurën e shkallës së parë të kundërvajtjes.

### **Afate të mjeteve juridike**

#### **Neni 126**

(1) Ankesa parashtrohet në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

(2) Gjykata e shkallës së dytë vendos më së voni në afat prej 60 ditësh nga dita e pranimit të ankesës, në mbledhje jopublike.

(3) Kur bëhet fjalë për të huaj, gjykata e shkallës së parë vendos menjëherë, ndërsa më së voni në afat prej tri ditë nga dita e pranimit të ankesës.

(4) Gjykata e shkallës së dytë mund ta anulojë vendimin e shkallës së parë dhe lëndën ta kthejë në gjykatën e shkallës së dytë nëse është propozuar nxjerrje e dëshmimeve të reja për të cilat pala nuk ka ditur dhe nuk ka mundur t'i propozojë në procedurën e shkallës së parë.

(5) Kur gjykata e shkallës së dytë vepron pas ankesës së deklaruar kundër vendimit i cili njëherë është anuluar dhe kthyer në zgjidhje të sërishme, ai vet në mënyrë të obligueshme do ta zgjidhë lëndën.

(6) Gjykata e shkallës së dytë gjatë vendosjes së sërishme nuk është e lidhur për kualifikimin juridik të përmbajtur në vendim.

(7) Kur gjykata e shkallës së dytë e përsërit vendimin e shkallës së parë të miratuar sipas nenit 113 paragrafit (7) të këtij ligji, nuk duhet doemos të japë arsyetim me shkrim në vendimin e saj.

Pjesa e gjashtë

Kreu i shtatëmbëdhjetë

## PROCEDURA TË VEÇANTA DHE ZBATIMI I VENDIMEVE

### **Procedura për konfiskim të pronës, dobisë pronësore dhe për marrje të sendeve**

Neni 127

Në procedurën për konfiskim të pronës, dobisë pronësore dhe marrje të sendeve zbatohen dispozitat të Ligjit për procedurë penale.

### **Kompensimi i dëmit dhe të drejta tjera të personave të cilëve u janë shqiptuar sanksione të kundërvajtjes**

Neni 128

Në procedurën për kompensim të dëmit dhe të drejta tjera të personave të cilëve u janë shqiptuar sanksione të kundërvajtjes, zbatohen dispozitat të Ligjit për procedurë penale.

### **Ekzekutimi i sanksioneve**

Neni 129

(1) Për ekzekutimin e sanksioneve, përveç gjobës, të shqiptuara në procedurë të kundërvajtjes zbatohen dispozitat të Ligjit për ekzekutim të sanksioneve.

(2) Për pagesë të detyrueshme të gjobës dhe shpenzimeve të procedurës, vlejné dispozitat e Ligjit për procedurë tatimore.

(3) Personi i gjykuar në afat prej 15 ditësh nga dita e pagesës është i obliguar që një ekzemplar të pagesës së kryer të gjobës dhe shpenzimet e procedurës së kundërvajtjes t'i dorëzojë te gjykata, përkatësisht organi i kundërvajtjes.

Pjesa e shtatë

Kreu i tetëmbëdhjetë

## DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 130

Procedurat e filluara para gjykatave dhe organeve të kundërvajtjes deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji do të përfundojnë sipas dispozitave të Ligjit për kundërvajtje ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 124/15).

Neni 131

(1) Kundër aktvendimeve për kundërvajtje të cilat i ka miratuar organi i kundërvajtjes mund të parashtrohet ankesë te Komisioni Shtetëror për Vendosje në Shkallë të Dytë në sferën e mbikëqyrjes inspektuese dhe procedurës së kundërvajtjes deri më 31 dhjetor 2020.

(2) Lëndët për procedurat e filluara për ankesë para Komisionit Shtetëror për Vendosje në Shkallë të Dytë në sferën e mbikëqyrjes inspektuese dhe procedurës së kundërvajtjes të cilat nuk do të përfundojnë në afatin nga paragrafi (1) i këtij neni, do të dorëzohen dhe do të vazhdojnë para Gjykatës Administrative.

Neni 132

(1) Ligjet në të cilat janë përcaktuar sanksione të kundërvajtjes do të harmonizohen me dispozitat e këtij ligji në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(2) Ligjet në të cilat janë përcaktuar sanksione të kundërvajtjes do të vazhdojnë të zbatohen deri në harmonizimin e tyre me dispozitat e këtij ligji, por më së voni gjashtë muaj nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 133

Rregullat nënligjore të parapara me këtë ligj do të miratohen në afat prej tre muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 134

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Ligji për kundërvajtje ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 124/15), përveç dispozitave të neneve 68 dhe 69 të këtij ligji të cilat do të zbatohen deri më 31 dhjetor 2020.

Neni 135

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", përveç dispozitave të nenit 70 të këtij ligji të cilat do të fillojnë të zbatohen nga 1 janari 2021.